



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.07.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i raportit vjetor "Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2018". (*Komision përgjegjës*)
2. Vazhdimi i shqyrtimit nen për nen të projektvendimit "Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 "Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar". (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Damian Gjijnuri, Edmond Leka, Bashkim Fino, Elena Xhina, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Ediola Braha, Alban Zeneli, Andi Permeti dhe Edlira Bode.

Mungojnë:

Fatmir Xhafaj, Alket Hyseni, Elda Hoti dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Naureda Llagami – Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor

Illir Toska – Anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor

Antuen Skënderi – përfaqësuese e Këshillit të Lartë Gjyqësor

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi për të vazhduar me dy çështjet që kemi në rendin e ditës së sotme është i pranishëm.

Çështja e parë është shqyrtimi i raportit vjetor "Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2018". Ne jemi komision përgjegjës, kurse relator do të jetë kolegu Adnor Shameti. Në shqyrtimin e këtij raporti Komisioni i Ligjeve është në ushtrimin e funksionit të kontrollit parlamentar. Sigurisht që Këshilli i Lartë Gjyqësor, për vitin 2018, po të kemi parasysh momentin e ngritjes dhe konstituimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka një aktivitet relativisht të shkurtër, por gjithsesi nga ana e këshillit na ka ardhur një raport i plotë dhe detajuar për të gjithë aktivitetin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nga momenti i krijimit deri në momentin që është dorëzuar raporti në Kuvend.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor zonja Naureda Llagami, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Toska, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe zonja Antuen Skënderi.

Mirë se keni ardhur në komision!

Zonja Llagami, raporti që ju keni paraqitur ju është shpërndarë kolegëve deputetë në rrugë elektronike, por edhe sot e kanë mbi tryezën e punës, ndaj do të kërkoja prej jush të bënit një prezantim të shkurtër të këtij raporti jo vetëm për kolegët, por edhe për opinionin publik. Më pas do ta marrë fjalën relatori, zoti Shameti, dhe fund do të kemi pyetje dhe përgjigje.

Fjala është për ju.

Naureda Llagami – Faleminderit!

I nderuar kryetar i Komisionit të Ligjeve,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Kam kënaqësinë të jem sot para jush dhe në emër të Këshillit të Lartë Gjyqësor të prezantoj veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2018, por edhe punën e kryer deri në datën 1.5.2019, datë e cila përkon me detyrimin ligjor që ka Këshilli i Lartë Gjyqësor për të depozituar raportin vjetor pranë institucionit tuaj. Gjithashtu, kemi gjetur rastin të bëjmë një pasqyrim mbi situatën dhe funksionimin e sistemit gjyqësor, sipas të dhënave statistikore të raportuara nga gjykatat e rretheve, atyre me juridiksion apeli, si dhe Gjykatës së Lartë.

Duke mbajtur në konsideratë që krijimi i KLGJ-së u bë me vonesë, me probleme të trashëguara kryesisht nga periudha tranzitore e funksionimit të ish-KLD-së, si dhe efektet që janë krijuar në organikat e gjykatës nga procesi i vlerësimit kalimtar, dua të bëj një parantezë

dhe t'ju sqaroj se viti 2018 i përket kryesisht veprimtarisë së ish-KLD-së, edhe pse veprimtaria e KLD-së nuk është përgjegjësi e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh detyrimin ligjor për të raportuar për vitin 2018, unë do të mundohem shkurtimisht t'ju parashtroj veprimet emergjente të ndërmarra nga KLGJ-ja në formën e reagimit ndaj situatave të gjetura, si përgjigje e domosdoshme e problemeve me të cilat u përball menjëherë nga momenti i konstituimit të saj, dhe duke ju përditësuar për nismat kryesore me rëndësi për të gjithë sistemin.

Kështu, ju sjell në vëmendje që me ndryshimet kushtetuese, konkretisht sipas nenit nr. 179 të Kushtetutës dhe nenit nr. 277 të ligjit për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë, parashikohet se ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë duhet të ushtronte veprimtarinë e tij tranzitore deri në ngritjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ky i fundit duhet të ngrihet në datën 12.4.2017.

Në kushtet kur situata faktike u zgjat përtej parashikimeve ligjore dhe ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë vijoi veprimtarinë e tij për më shumë se 19 muaj të tjerë, mos krijimi i KLGJ-së brenda afateve të përcaktuara, krijoi problematikë në funksionimin e sistemit të drejtësisë në tërësi, më konkretisht në garantimin e të drejtave statutores të gjyqtarëve, në miradministrimin e gjykatave, në kompetencat e paplota të ish-KLD-së, të cilat nuk garantonin pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe eficiencën e duhur për sistemin gjyqësor.

Veçanërisht, për sa i përket statusit të gjyqtarëve, për një kohë të gjatë u krijua një pasiguri dhe paqartësi, e cila konsistonte në procesin e emërimit të magistratëve të rinj, dhënien e lejeve për ushtrimin e veprimtarive akademike apo të llojeve të tjera, garantimin e një procesi të rregullt ligjor në funksion të shkeljeve të procedimit disiplinor për shkak të shfuqizimit të shkeljeve disiplinore nga Gjykata Kushtetuese, si edhe në mosvijueshmërinë e procesit të vlerësimit profesional të gjyqtarëve, duke u fokusuar vetëm në procesin e rivlerësimit kalimtar.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me krijimin e tij, u përball me vakuumin që u krijua në drejtim të disa gjykatave si pasojë e shkarkimit të kryetarëve të tyre gjatë procesit të vetingut.

Në këtë drejtim, menjëherë pasi u ngrit, Këshilli i hapi rrugë zgjedhjes së zëvendëskryetarëve të gjykatave duke miratuar rregulloret përkatëse. Zgjedhja e tyre plotësonte vakuumin ligjor që krijonte në rast të mungesës së kryetarit, pasi ligji, sikurse jeni në dijeni, parashikonte që në mungesë të kryetarit detyrat i ushtron zëvendëskryetari i gjykatës.

Aktualisht, dua t'ju informoj se janë zgjedhur 36 zëvendëskryetarë nga 37 gjykata të nivelit të parë dhe të dytë.

Çështja e dytë që dua të rendis si çështje prioritare, për të cilën Këshilli mori masa menjëherë, ishte bashkëpunimi me organet e vetingut apo bashkëpunimi me institucionet e

vlerësimit kalimtar. Ky bashkëpunim kryhej si pjesë e veprimtarisë së Inspektoratit të ish-KLD-së. Pas përfundimit të mandatit të KLD-së, për të mos penguar ose për të mos ngadalësuar procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe subjekteve të tjerë, Këshilli, me një vendim të tijin të datës 22.01.2019, ngriti një komision të përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit, si dhe miratoi rregullat përkatëse për t'i dhënë një shtysë dhe garanci këtij procesi.

Si rezultat i sa më sipër, Këshilli ka kontribuar deri tani me përpilimin dhe dorëzimin e 62 raporteve të vlerësimit pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, duke asistuar në këtë mënyrë institucionet e rivlerësimit sipas pritshmërive në procesin e vlerësimit profesional të gjyqtarëve.

Gjithashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas krijimit, gjeti një stok me 184 kërkesa të ardhura nga gjykatat, ku kërkohet delegimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të caktuara, për shkak se gjykatat ishin në pamundësi të plotësimit të trupës gjyqësore. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka trajtuar pa vonesë 485 kërkesa të ardhura nga gjykatat për delegim, ku nga një gjykatë ka raste që kërkohet delegimi i gjyqtarëve për disa çështje gjyqësore. Këshilli i Lartë Gjyqësor vazhdon edhe sot hedhjen e shorteve për të plotësuar këto nevoja të gjykatave.

Deri në muajin prill të vitit 2019 janë kryer nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor delegimet e gjyqtarëve për 427 çështje, ndërsa në muajin qershor ky numër ka shkuar në 706 çështje.

Më tej, në muajin korrik të vitit 2018, dhjetë kandidatë magistratë përfunduan Shkollën e Magistraturës, por nuk u emëruan, duke qenë se ligji “Për statusin” parashikonte vetëm emërimin e kandidatëve magistratë, të cilët përfundonin shkollën deri në vitin 2016. Në këto kushte, KLD-ja e mëparshme ishte në pamundësi për t'i emëruar këta kandidatë. Për çdo kandidat që diplomohet pas vitit 2016 kompetente ishte vetëm KLGJ-ja që duhej të ngrihej.

Në kushtet kur kjo e fundit u ngrit pas vetëm 19 muajsh, kandidatët të cilët u diplomuan në vitin 2018 mbetën të paemëruar, duke e bërë edhe këtë çështje objekt të shqyrtimit gjyqësor. Vendimi gjyqësor, kuptohet, u mor në favor të kandidatëve magistratë, duke krijuar një kosto të lartë financiare për KLGJ-në e sapokrijuar, si dhe për sistemin, i cili ka nevojë më shumë se kurrë për magistratë në këtë situatë.

Mbështetur në kuadrin ligjor, konkretisht në ligjin “Për statusin”, në mbledhjen e datës 27.12.2018 Këshilli i Lartë Gjyqësor e trajtoi me prioritet këtë çështje, duke vendosur fillimin e procesit të verifikimit të pasurisë dhe të figurës si parakusht për emërimin e tyre, proces i cili u plotësua më vonë, dhe miratimin e rregulloreve përkatëse.

Sot që jemi para jush dua t'ju informoj se KLD-ja e ka përfunduar procesin e verifikimit të kritereve dhe të kushteve ligjore, të pasurisë dhe figurës, si dhe është gati t'i emërojë dhe t'i caktojë këta magjistratë brenda muajit korrik të vitit 2019.

Një çështje tjetër që lidhet me situatën e bartur ka të bëjë me një stok prej 183 ankesash nga institucionet apo qytetarët kundër vendimmarrjes së kryeinspektores së ish-KLD-së për mbylljen ose për pushimin e hetimeve ndaj gjyqtarëve për shkelje të pretenduara nga institucionet apo edhe nga qytetarë. Stoku i ankesave nga qytetarët kishte mbetur i patrajtuar.

Për t'i dhënë zgjidhje kësaj shtate të gjetur, si dhe shqetësimeve të qytetarëve, me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, datë 14.02.2019, ky i fundit ngriti një komision të përkohshëm për shqyrtimin e këtyre ankesave. Deri më tani ky komision ka trajtuar me vendimmarrje 127 ankime. Këto vendimmarrje përbëjnë një premisë ose shërbejnë si indicie për procedime disiplinore nga ana e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për ata gjyqtarë, ankesat ndaj të cilëve janë gjetur të bazuara. Kjo qasje garanton vijueshmërinë institucionale për të mbajtur dhe për të promovuar në sistem vetëm ata gjyqtarë, të cilët kanë ruajtur në mënyrë konstante vlerat, integritetin profesional e moral në ushtrimin e detyrës. Në të njëjtën kohë, kjo qasje garanton trajtimin me seriozitet dhe marrjen në konsideratë të çdo ankese të individit.

Përveç sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka ndërmarrë edhe nisma të tjera për sa i përket përbushjes së detyrimeve ligjore dhe vlerësimit të nevojave imediate të sistemit. Konkretisht, ka ngritur komisionet e përhershme, që është një mënyrë e veprimtarisë së Këshillit. Këto komisione janë ngritur duke marrë parasysh ngarkesën e secilit komision, eksperiencën e secilit anëtar, si dhe raportet ndërmjet anëtarëve gjyqtarë dhe jogjyqtarë.

Si rezultat i punës së deritanishme të komisioneve të përhershme, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kaluar në seancë plenare 83 vendimmarrje që nga krijimi i komisioneve dhe 101 vendimmarrje në total që nga krijimi i Këshillit, duke përfshirë edhe aktet nënligjore me karakter normativ për rregullimin e situatave që prekin të gjithë sistemin gjyqësor.

Një nismë tjetër, si kërkesë prioritare e ligjit, është edhe ngritja e gjykatave të posaçme.

Në mbështetje të detyrimeve ligjore të parashikuara nga ligji “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” dhe ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” që, në mbledhjen e tretë, nga momenti i konstituimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Këshilli e konsideroi me prioritet nisjen e procesit për ngritjen e gjykatave të posaçme, të cilat do të kenë për objekt shqyrtimin e çështjeve kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Në këtë kuadër, nisja e kësaj procedure konsistonte duke u kërkuar pëlqimin gjyqtarëve për të qenë pjesë e këtyre gjykatave, si dhe pëlqimin e

familjarëve të tyre për të dhënë autorizimin e kontrollit të llogarive bankare dhe të komunikimeve vetjake.

Aktualisht, kanë dhënë pëlqim për caktimin në gjykatën e posaçme 14 gjyqtarë nga 14 gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe 8 gjyqtarë nga 11 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda. Ky është një proces, i cili, nga ana e Këshillit, po koordinohet me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në mënyrë që të mos cenohet funksionalizimi i Gjykatës së Krimeve të Rënda, deri në krijimin e Prokurorisë së Posaçme.

Gjithashtu, Këshilli ka parashikuar si një nga prioritetet e tij edhe riorganizimin e gjykatave dhe të kompetencave të tyre tokësore. Kështu, në muajin shkurt të këtij viti Këshilli ka ngritur një grup pune të përbërë nga përfaqësues të këshillit, kryetarë gjykatash, gjyqtarë, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Qëllimi i këtij grupi pune është të merret me hartimin e hartës gjyqësore, që është një nga detyrimet që buron nga ligji. Nga ana e grupit të punës po vlerësohet gjendja aktuale përkundrejt disa treguesve të rëndësishëm, që përdoren edhe nga vendet europiane, për rritjen e efikasitetit të gjyqësorit. Këta tregues kanë të bëjnë, së pari, me volumin e çështjeve në gjykata.

Së dyti, me largësinë gjeografike ndërmjet rretheve gjyqësore.

Së treti, me popullsinë në hapësirën e qarkut.

Së katërti, me indeksin social-ekonomik.

Ajo që është e pritshme të bëjë grupi i punës është të ofrojë tri propozime për riorganizimin e hartës gjyqësore. Nga ana tjetër, ky lloj produkti do të konsultohet me Ministrinë e Drejtësisë dhe me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, përpara se të miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Vlen të theksohet që ky është një nga prioritetet më të rëndësishme të Këshillit, pasi riorganizimi i hartës gjyqësore do të mundësojë vendosjen e një ekuilibri ndërmjet numrit të gjyqtarëve në funksion të aksesit të qytetarëve në drejtësi, uljes së kostove, rritjes së cilësisë së shërbimeve gjyqësore, me fjalë të tjera, në përmirësimin e performancës së sistemit gjyqësor në tërësi.

Një nismë tjetër tejet e rëndësishme është edhe ajo lidhur me detyrimet që burojnë nga ligji “Për tarifatat gjyqësore”. Sikurse e dini, një nga detyrimet, që burojnë nga ky ligj, është që Këshilli duhet t’i propozojë Ministrisë së Drejtësisë vlerën, llojin dhe proporcionalitetin e vendosjes së tarifave gjyqësore. Kjo është një nismë mjaft e rëndësishme, pasi ka një impakt të drejtpërdrejtë në publik dhe Këshilli ka treguar shumë kujdes, duke hartuar një studim të mirëfilltë lidhur me tarifatat që do të aplikohen. Këshilli ka mbajtur parasysh që për njerëzit në nevojë tarifatat gjyqësore të jenë zero. Kjo nismë është në proces konsultimi me Ministrinë e

Drejtësisë dhe shumë shpejt pritet të hartohet projektudhëzimi nga Ministria e Drejtësisë bashkë me Ministrinë e Financave.

Raportimi që po bëj në emër të Këshillit të Lartë Gjyqësor është depozituar në Kuvend. Ne deshëm që raportimin tonë, për shkak të rëndësisë së situatës në të cilën po vepronte Këshilli, ta shtynim përtej muajit prill të vitit 2019, duke dashur t'ju përditësojmë lidhur me disa vendime substanciale që Këshilli ka marrë rishtazi.

Siç mund të jeni në dijeni, KLGJ-ja tashmë ka miratuar dy akte shumë të rëndësishme për përhapjen e procesit të kandidimit të anëtarëve në Gjykatën e Lartë. Akti i parë ka të bëjë me rregulloren për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të pasurisë dhe figurës së të gjithë kandidatëve magjistratë, që synojnë t'i bashkohen sistemit gjyqësor, por edhe të promovohen në gjykata më të larta. Ndërsa rregullorja e dytë, që kemi miratuar së fundi, së bashkë me matricën vlerësuese, përcakton procedurën, vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve jogjyqtarë sipas kriterëve profesionale për në Gjykatën e Lartë.

Sikurse jeni në dijeni, një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë duhet të vijë nga radhët e juristëve të spikatur. Për këtë arsye Këshilli ka ndërtuar, le të themi, infrastrukturën e duhur ligjore për nisjen e procesit të emërimit për anëtarët në Gjykatën e Lartë, duke vendosur parakushte të domosdoshme për çdo kandidat.

Duhet të sqaroj se, pavarësisht që Këshilli ka punuar lidhur me hartimin e këtyre rregulloreve, tashmë po punon paralelisht edhe për procesin e vlerësimit profesional, i cili është mjaft i rëndësishëm dhe në kompetencë të KLGJ-së, edhe pse duhet ta pranojmë që situata e trashëguar nga institucioni pararendës ka krijuar vështirësi, pasi vlerësimet profesionale nën drejtimin e ish-KLD-së kanë përfunduar vetëm për periudhën 2007-2009. Mund ta merrni vetë me mend se nga viti 2009 deri tani në sistemin e drejtësisë kanë hyrë breza të tërë magjistratësh, të cilët janë të pavlerësuar. Kjo gjë krijon një situatë penguese për promovimin e tyre në gjykata apo në instanca më të larta.

Gjithashtu, dua t'ju informoj se jo më larg sesa dje Këshilli shpalli garën për vendet vakante për anëtarë në Gjykatën e Lartë, që vijnë nga radhët e juristëve të spikatur. Kemi shpallur konkretisht tri pozicione vakante, sipas fushave të përcaktuara të ekspertizës: në fushën administrative, penale dhe civile. Pritet që shumë shpejt, me miratimin e rregullave për vlerësimin profesional dhe fillimin e vlerësimit profesional, të hapim edhe thirrjen publike për promovimin e magjistratëve që duan të shkojnë në Gjykatën e Lartë.

Dy gjëra të tjera, që do të doja t'i theksoja, pasi mendoj se janë risi të implementimit të reformës, janë, në radhë të parë, krijimi i këshillave të gjykatës. Sikurse ju e dini, tashmë për shkak të reformës, mënyra e administrimit të gjykatës ka ndryshuar: gjykata sot nuk

administrohet nga një person i vetëm, siç ishte kryetari i gjykatës, por administrohet nga një këshill, pra nga një organ kolegjal. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka bërë të mundur që brenda të gjitha afateve ligjore, që ligji përcaktonte, brenda katër muajve të ngrinte këto organe nëpër gjykata për t'i lejuar këto gjykata që tashmë të vetadministrohen. Në këtë mënyrë ka garantuar demokratizimin e pjesëmarrjes së anëtarëve në gjykatë.

Një tjetër vendim mjaft i rëndësishëm, i ndërmarrë nga KLGJ-ja në kuadrin e reformës, është edhe miratimi i rregullave për përshpejtimin e çështjeve në Gjykatën e Apelit. Gjithsecili nga ne ka pasur komente për sa u përket rregullave se si një Gjykatë Apeli e kalonte një çështje për gjykim dhe përshpejtonte gjykimin. Sot, me miratimin e këtij vendimi, Këshilli ka normuar se cili është objekti i çështjeve, për të cilat mund të lejohet përshpejtimi në Gjykatën e Apelit, si dhe procedurat dhe njoftimin që u bëhet palëve në këtë gjykatë, duke kontribuar në këtë lloj mënyre drejtpërdrejt për rritjen e efikasitetit, aksesit dhe cilësisë së dhënies së drejtësisë.

Kjo ishte një panoramë për sa i përket vendimmarrjes së Këshillit nga 20 dhjetori i vitit të kaluar deri tani.

Ndërkohë, si pjesë e detyrimit ligjor, dua të ndalem te gjendja e sistemit gjyqësor. Pjesë e këtij raporti, sikurse jeni vënë në dijeni, është një analizë e aktivitetit të sistemit gjyqësor për vitin 2018. Kjo analizë synon të ofrojë një panoramë të përgjithshme të gjendjes së sistemit në fillim të vitit 2019 në lidhje me ngarkesën e punës në gjykatat e vendit dhe kohën e trajtimit të çështjeve, si tregues kryesor i mbarëvajtjes së sistemit gjyqësor.

Para se të kaloj tek të dhënat konkrete, duhet të sqaroj diçka për komisionin. Duhet ta pranojmë që ky vlerësim i sistemit kryhet për herë të parë, pasi nuk kemi gjetur një analizë të tillë nga institucioni pararendës, në mënyrë që të bënim një krahasim të nevojshëm të ecurisë së punës. Vlerat, që raportohen, janë të nxjerra manualisht nga gjykatat dhe nuk përjashtohet të kemi edhe një marzh gabimi, duke qenë se sistemi ICMIC, për hir të së vërtetës, nuk gjeneron të dhëna të sakta as në kohë reale. Megjithatë, besojmë që këto vlera, pavarësisht të marra manualisht, nuk ndikojnë në thelbin e gjendjes që ne kërkojmë t'ju parashtrojmë sot.

Pika e tretë, që vlen të theksohet, është që këto të dhëna janë bazuar në një model të strukturuar numerik, në indikatorë specifikë që ndikojnë tek analizat, të cilat do t'i sintetizoj më poshtë. Kështu, menjëherë, kur filluam punën për hartimin e raportit, Këshilli u ka kërkuar të gjitha gjykatave numrin e gjyqtarëve efektivë. Çfarë duhet të kuptojmë me numrin e gjyqtarëve efektivë? Ky nuk është numri i gjyqtarëve sipas organikës, sepse, sikurse jeni në dijeni, për shkak të vetingut, ka vakanca fiktive pas pezullimit që bën KPK-ja, por janë gjyqtarët që ndikojnë realisht në volumin e çështjeve.

E dhëna e dytë mbi të cilën është bazuar ky raport është numri i çështjeve të mbartura në vitin 2017, siç quhet ndryshe *backlog*-u.

E dhëna e tretë është numri i çështjeve të regjistruara në vitin 2018, që nënkupton çështjet e reja.

Tek e dhëna e katërt përfshihet numri i çështjeve të përfunduara në vitin 2018, si dhe numri i çështjeve të mbartura nga viti 2018 në vitin 2019, e cila në thelb na jep një tablo të qartë të *backlog*-ut që do të ketë në vijim sistemi.

Të gjitha këto të dhëna janë parë në kuptimin e indikatorëve që aplikohen sot nga CEPEJ-i dhe është detyrim për sistemet që të aplikohen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

CEPEJ-i është trupë gjyqësore e Komisionit Europian për efizienzën në drejtësi.

Në kuptimin e këtyre indikatorëve, ne jemi munduar t'i analizojmë treguesit e kohës së nevojshme për përfundimin e çështjeve, raportin e qarkullimit të çështjeve, si dhe koeficientin e shpejtësisë së gjykimit. Konkretisht, konstatohet se nga gjykatat e rretheve me ngarkesë më të madhe çështjesh është Gjykata e Rrethit Tiranë, e cila ka një ngarkesë prej 33 712 çështjesh. Më pas vijon Gjykata e Rrethit Vlorë me 7046 çështje, Gjykata e Rrethit Shkodër me 6637 çështje. Nga gjykatat e apelit rendisim të parën Gjykatën e Apelit Tiranë me 6245 çështje, duke vijuar me Gjykatën e Apelit Vlorë me 3734 çështje.

Ndërkohë, në juridiksionin administrativ kuptohet që Gjykata Administrative e Apelit është më e ngarkuara me 4111 çështje. Por ajo që duam të shpjegojmë këtu është si qëndron ky volum çështjesh përkrah punës për evadimin e tyre. Kjo evidentohet nga një tregues, që në aspektin teknik të referuar në raport, quhet treguesi CR ose, me fjalë të tjera, norma e zgjidhjes së çështjeve, pra raporti ndërmjet çështjeve të reja dhe çështjeve që janë përfunduar brenda një periudhe kohore. Ky indikator, në fakt, ofron një trend të përgjithshëm lidhur me gjendjen e sistemit gjyqësor për sa i përket ecurisë së sistemit në harkun kohor prej 1 viti, pra ofron një pasqyrë nëse gjykatat kanë arritur ta ruajnë ritmin ndërmjet çështjeve të reja të regjistruara dhe atyre të përfunduara. Kjo normë e shprehur në përqindje duhet analizuar së bashku me kohën e nevojshme për likuidimin e këtyre çështjeve në gjykatë, që është një tregues tjetër, të cilin e kemi referuar në raport dhe quhet treguesi DT.

Sipas modelit metodologjik në raport, këta tregues jepen të disagreguar ose të kategorizuar sipas llojit të çështjeve, pra sipas natyrës së çështjeve: penale, civile dhe administrative.

Në tërësi, nga grafikët që prezantohen në raport, shihet qartë se pjesa më e konsiderueshme e gjykatave ruajnë vlerën 70% të normës së zgjidhjes së çështjeve, pavarësisht

natyrës ose llojit të tyre. Sigurisht, ka edhe raste kur gjykatat raportojnë mbi 100% të normës, por ka edhe nivele të ulëta, që janë më pak se 50%, por e rëndësishme për të kuptuar është se çfarë duhet të kuptojmë në kur kemi vlerën mbi 100% dhe kur kemi vlerën nën 50%. Në rastet kur vlera kalon 100%, do të thotë se kjo gjykatë ka arritur të trajtojë një numër çështjesh më të mëdha sesa fluksi i çështjeve të ardhura. Pra, ka ruajtur ritmet për të evaduar çështje të mbartura duke gjykuar çështje të reja. Nëse treguesi është nën vlerat mesatare, kjo tregon se ne kemi një problem, ose gjykata gjendet në pamundësi, me fjalë të tjera, nuk performon. Këto situata duhet të shërbejnë si alarm për Këshillin e Lartë Gjyqësor, i cili, përveç evidentimit në statistika, duhet të shohë se ku qëndrojnë problemet e performancës të kësaj gjykate dhe t'i adresojë në mënyrën e duhur.

Një analizë tjetër që kemi pasqyruar në raport është edhe analiza e *backlog*-ut në shkallë vendi. Nëse do ta shohim situatën në nivel makro, duhet të pranojmë se kemi *backlog*-ë, të cilët janë problematikë në kuptimin e kohëzgjatjes së gjykimit dhe në analizë evidentohet ky lloj *backlog*-u. Kështu, gjatë vitit 2018, flasim për të gjitha gjykatat, janë regjistruar 147423 çështje, nga këto për vitin 2018 janë mbyllur 75803 çështje në shkallë vendi, të cilat ishin të patrajuara. Duhet t'ju kujtoj se në të gjithë këtë grupim prej 75803 çështjesh, vetëm 28863 çështje i përkasin Gjykatës së Lartë. Pra, para një viti flitej për 68982 çështje të prapambetura dhe, pavarësisht uljes së numrit të gjyqtarëve për shkak të procesit të vetingut dhe rritjes së *backlog*-ut të një viti më parë, norma e përgjithshme e evadimit të çështjeve në rang vendi për të gjitha gjykatat është në rendin 91%, duke përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, ose 100% nëse nuk e marrin në llogari Gjykatën e Lartë, që në rastin konkret është një rast i veçantë. Ky raport evadimi tregon se gjyqësori ka ruajtur deri diku ritme të kënaqshme krahasuar me mesataren europiane.

Për sa i përket mesatares europiane, unë kam marrë të dhëna dhe i kam pasqyruar në raport, ku kam evidentuar se sipas faqes së CEPEJ-it mesatarja europiane e evadimit të çështjeve për vitin 2016 ka qenë 101,2% për çështjet civile dhe 118% për çështjet penale. Pra, në tërësi, ne mund të themi që për sistemin kemi një ritëm të kënaqshëm në evadimin e çështjeve, duke e marrë Gjykatën e Lartë si një situatë të izoluar.

Nga ana tjetër, duke qenë së për herë të parë KLGJ-ja duhet të raportojë edhe për Gjykatën e Lartë, nga informacionet e ardhura nga kjo gjykatë, në kushtet e funksionimit të saj efektivisht vetëm me 2 anëtarë nga 19, konstatohet se në fund të vitit 2017 numri i çështjeve të mbartura ishte 22000, ndërsa në fund të vitit 2019 ky numër ishte 28863. Gjatë vitit 2018 u arrit të zgjidhen nga kjo gjykatë 1673 çështje, pavarësisht numrit të vogël të gjyqtarëve që kishte në këtë gjykatë, ku secili nga këto gjyqtarë mesatarisht kanë gjykuar 279 çështje.

Aktualisht, sot që flasim, raportohen të jenë rreth 31000 dosje në pritje për t'u gjykuar në Gjykatën e Lartë.

Kjo ishte një pasqyrë e shkurtër e gjetjeve, ndërkohë, nëse ju na lejoni, mund t'ju themi edhe angazhimin që Këshilli ka për vitin 2019. Kuptohet, ne jemi shumë koshientë për problematikat e shkuara dhe sfidat që kemi në të ardhmen. Gjatë këtij viti Këshilli do të vazhdojë intensivisht bashkëpunimin me organet e vetingut, si proces prioritar, do të finalizojë të gjitha rregulloret, edhe ato të prapambetura për promovimin e gjyqtarëve në gjykatat më të larta, bashkëpunimin me Këshillin e Lartë të Prokurorisë për të mundësuar sa më shpejt ngritjen e gjykatës së posaçme kundër korrupsionit, emërimin dhe caktimin në detyrë të magjistratëve, që kanë përfunduar studimet për vitet 2018 dhe 2019, një bashkëpunim më intensiv me Ministrinë e Drejtësisë për ngritjen e qendrës së teknologjisë së informacionit dhe sistemit të integruar, si dhe nisjen e një analize tërësore për problemin e sistemit dhe hartimin e masave afatmesëm, që mund të sjellin përmirësime në sistem.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Llagami!

Fjalën e ka zoti Shameti, i cili do të na bëjë një prezantim të gjetjeve nga ana e Komisionit të Ligjeve lidhur me raportin që ju keni paraqitur, pastaj vazhdojmë me pyetjet.

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Në radhë të parë dua të falënderoj përfaqësuesen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për prezantimin shterues dhe të zgjeruar të raportit para Komisioni të Ligjeve.

Për të gjithë anëtarët dua të sqaroj se ky është raportimi i parë që bëhet para Komisionit të Ligjeve nga përfaqësuesit e KLGJ-së, si një organ i ri i konstituuar pas ligjit nr. 115 të viti 2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në të cilin parashikohet shprehimisht se Këshilli i Lartë Gjyqësor raporton para Kuvendit për gjendjen e sistemit gjyqësor gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, jo më pak se një herë në vit. Raporti përshkruan veprimtarinë e Këshillit dhe të komisioneve të tij, si dhe përmban rekomandimet për përmirësimet e nevojshme. Duke qenë se KLGJ-ja është institucion i ri i drejtësisë, i cili është ngritur në dhjetor të vitit 2018, është e kuptueshme që për kaq pak kohë nuk mund të raportohet gjendja në tërësi, por nga raporti i paraqitur dhe prezantimi sot është e qartë se informacioni që u përcoll jep një panoramë të plotë të gjendjes së përgjithshme të sistemit gjyqësor dhe plotëson ato detyrime që ky Këshill ka para Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Nuk dua të përsëris ato që u prezantuan në raportin e detajuar të përfaqësuesve të KLGJ-së, por dua të flas më shumë për gjetjet e mia personale si relator, duke shprehur shqetësimin dhe impenjimin si të Komisionit të Ligjeve, ashtu edhe pyetjeve dhe shqetësimeve që ka opinioni publik lidhur me ecurinë e përmbylljen e reformës në drejtësi dhe konstituimin e të

gjitha organeve përkatëse. Dua të rendis një sërë konstatimesh ose pyetjesh, për të cilat gjetëm pjesërisht përgjigje në raportin tuaj, por dua që edhe për opinionin publik të dilnin më në pah këto konstatime.

Së pari, si pasojë e procesit të vetingut janë krijuar vakanca në gjykata në vend, cilat janë ato gjykata që funksionojnë në mungesë të konsiderueshme të gjyqtarëve dhe çfarë masash po merren për mbarëvajtjen e punës në këto gjykata?

Ju mund t'i shënoni pyetjet dhe, nëse ju duhet më shumë kohë, mund t'i ktheni përgjigje me shkrim ose të na bëni në mënyrë të përmbledhur detajet e këtyre gjetjeve.

Së dyti, në kuadër të procesit të vetingut, KLGJ-ja bashkëpunon me organet e rivlerësimit kalimtar për komponentin e aftësive profesionale, si ka ecur ky bashkëpunim midis jush dhe organeve të vetingut?

Së treti, siç ju e përmendet pjesërisht në raportin tuaj, për zbatimin e ligjeve të reformës në drejtësi janë një sërë aktesh nënligjore që duhet të nxjerrë KLGJ-ja dhe, siç e shpjeguat, ju po bashkëpunoni me EURALIUS-in për këto akte, si ka ecur puna dhe kur mendoni se kryhet i plotë ky proces, nga ku varet edhe përmirësimi i sistemit gjyqësor?

Së katërti, në relacion keni shprehur vakancat për Gjykatën e Lartë, kur mendoni se bëhet funksionale kjo gjykatë? Kjo është një pyetje e rëndësishme që shqetëson mbarë opinionin publik, edhe ne si anëtarë të Komisionit të Ligjeve.

Së fundi, kam një pyetje për organizimin e punës së institucionit, si po ecën ristrukturimi dhe a keni pengesa në praktikë me të gjithë kolaudimin e institucionit?

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Shameti!

Zonja Llagami, a jeni gati për përgjigjen e pyetjeve të relatorit?

Naureda Llagami – Po, jam gati.

Unë do të mundohem të jem ezuaruese për sa mundem dhe sa më lejon koha këtu.

Lidhur me procesin e vetingut, cilat janë pasojat e këtij procesi dhe cilat janë gjykatat që janë prekur më shumë, ju duhet ta kuptoni që ky është një proces në vazhdimësi. Në momentin që unë kam bërë raportimin dhe përditësimin deri në këto momente, unë mund t'ju përmend 24 mungesa në gjyqësor deri në muajin qershor. Për mënyrën sesi është shpërndarë kjo lloj vakance ne duhet të marrim një informacion të detajuar se cilat janë gjykatat vakante, që mund t'jua vë në dispozicion, por një nga situatat më emergjente, e cila është krijuar kohët e fundit, është ajo e Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Shkodër, në të cilën u shkarkua kryetarja e kësaj gjykate dhe është vetëm një gjyqtar, i cili edhe ai është i transferuar përkohësisht në atë gjykatë. Kjo është një gjykatë emergjente, për të cilën Këshilli do të reagojë

brenda kësaj jave. Për vakancat në gjykatat e tjera unë mund t'ju jap një informacion të detajuar lidhur me shpërndarjen e këtyre vakancave. Këshilli është munduar që sa herë janë krijuar vakancat për kryetarë të gjykatave, ka reaguar shpejt me zgjedhjen e zëvendëskryetarëve, sepse drejtuesi i një institucioni, në aspektin procedural dhe administrativ të gjykatës, është shumë i rëndësishëm.

Nga ana tjetër, lidhur me pjesën e vakancave që krijohet, mjafton të shohim numrin e kërkesave të çështjeve për delegim për trupën gjyqësore dhe kuptohet që kemi një impakt të rëndësishëm që krijohet nga vetingu, por që Këshilli po mundohet të reagojë në kohë reale dhe për të adresuar siç duhet, në mënyrë që vonesat në proces të mos ndjehen nga qytetarët.

Për sa i përket procesit të vetingut, siç jeni në dijeni, në kuadër të ligjit për rivlerësimin, roli i Këshillit është një nga komponentët e këtij rivlerësimi, që lidhet me komponentin për aftësinë profesionale. Unë u mundova ta sqaroj edhe në raportim, që ne kemi filluar pa vonesë në trajtimin e kësaj çështjeje, sepse deri në momentin që ishte KLD-ja kryhej nga inspektorati, ndërkohë ne krijuam një komision, i cili përbëhet nga 5 anëtarë, ku pjesa më e madhe janë gjyqtarë dhe këto merren intensivisht me hartimin e raporteve për aftësitë profesionale. Deri tani Këshilli ka reaguar duke dorëzuar 61 raporte pranë komisioneve të vetingut. Procesi i vetingut për Këshillin është një proces prioritar dhe deri tani nuk kemi krijuar hapësira për vonesa në këtë proces.

Për sa i përket çështjes lidhur me hartimin e akteve nënligjore dhe bashkëpunimit që kemi me partnerët ndërkombëtarë, unë e kam pranuar në të gjitha mbledhjet që Këshilli ka zhvilluar deri tani se asistenca nga partnerët ndërkombëtarë është një asistencë mjaft e vyer, e cila ka mundësuar që Këshilli të reagojë më shpejt, duke kuptuar që i gjithë kuadri ligjor është një kuadër i ri, i cili ka përfshirë koncepte të reja dhe mënyra të reja bashkëkohore të vlerësimit e të menaxhimit të gjyqësorit, ku asistenca e tyre ka qenë mjaft e vyer dhe shumë e vlerësuar nga ana e Këshillit. Është e rëndësishme ta themi se për efekt të ngarkesës së punës, duhet të pranojmë se Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin në kuptimin që të miratojë 62 akte nënligjore (po flasim vetëm për karakterin normativ), pra akte normative që rregullojnë çështje të caktuara. Kuptohet, duhet të merren parasysh sfidat që ka Këshilli, sepse është një institucion i ri që ka vetëm 6 muaj ekzistencë. Këto sfida janë ristrukturimi i institucionit, mënyra e re e qeverisjes, sepse kemi një institucion me kompetenca të tjera, tashmë më gjithëpërfshirëse, në lidhje me gjyqësorin. Pra, ka pasur sfida për të gjithë ne anëtarët e Këshillit, pra për të gjithë Këshillin si organ kolegjal, por kuptohet Këshilli është munduar që të prioritetizojë çështjet kryesore.

Dua t'ju informojë se Këshilli në mbledhjen e radhës ka në plan hartimin dhe miratimin e një plani strategjik. Në përputhje me strategjinë ndërsektoriale të drejtësisë, ka prioritetuar nismat, të cilat duhen bërë brenda periudhës 2019-2020, sipas afateve që parashikon ligji, sipas mundësive dhe mbështetjes që ka Këshilli dhe nevojave ndaj gjyqësorit, si dhe për t'iu përgjigjur publikut.

Pyetja se kur do të bëhet funksionale Gjykata e Lartë, të them të vërtetën kjo pyetje na ka shqetësuar që në fillim, që kur kemi shkuar në atë godinë. Pra, një nga prioritetet, që ka pasur Këshilli, është si të bëjë sa më eficiente Gjykatën e Lartë, por, nga ana tjetër, të kujdeset edhe për mirëfunksionimin e gjyqësorit. Duhet të kuptoni që mirëfunksionimi i gjyqësorit, nuk është vetëm Gjykata e Lartë, por janë edhe gjykatat, që për shkak të vetingut, ashtu siç e dini, kanë krijuar mungesa, zvarritje të proceseve, për mungesë të gjyqtarëve apo për pezullimin e tyre. Këshilli jo më kot ka reaguar në mënyrë të shpejtë ndaj këtyre situatave. Ndërkohë, për Gjykatën e Lartë Këshilli ka pasur si prioritet dhe si objektiv t'u garantojë qytetarëve shqiptarë, të cilët do të shkojnë në Gjykatën e Lartë, kandidatëve për në Gjykatën e Lartë, se do të kenë të njëjtat kushte, garanci, integritet, dhe të njëjtin profesionalizëm, për të cilin ne sot kemi bërë këtë reformë. Nuk mundej kurrësi që Këshilli të mos lejonte të miratoheshin rregulloret dhe të mos vendoseshin standardet për kritere objektive për verifikimin e figurës dhe pasurisë për personat që kërkojnë të shkojnë në Gjykatën e Lartë. Ne sot jemi në dijeni dhe jemi koshientë që sistemi po vuan dhe është në një situatë të vështirë, ku një pjesë e gjyqtarëve po largohen nga sistemi, pikërisht për shkak të integritetit dhe për shkak të elementeve të tjera. Sot nuk mund të lejojmë që të futim në sistem njerëz të paverifikuar dhe të pavetuar. Për këtë arsye Këshilli ka parë si emergjencë çështjen e hartimit të dy projektregulloreve, që, në thelb, kanë krijuar një standard. Është hera e parë që kandidatët, që do të shkojnë në Gjykatën e Lartë, do t'i nënshtrohen një procedure me kriter objektiv, një procedure transparente për vlerësimin e tyre. Kjo është një risi jo e këshillit, por është një risi e reformës, për të cilën ne sot kemi shpresuar.

Për sa i përket pjesës se kur do të bëhet eficiente Gjykata e Lartë, unë ju informova se në lidhje me anëtarët, që vijnë nga jashtë gjyqësorit, që u përkasin juristëve të spikatur, shpallja është bërë dhe është e pritshme në bazë të procesit të verifikimit, pra është një proces ku komunikohet ndërmjet të gjitha institucioneve dhe bëhet vlerësimi i pasurive, vlerësimi i figurës, më pas vlerësimi i kushteve ligjore, vlerësimi i kritereve objektive profesionale.

Në si Këshill jemi optimistë dhe besoj se në vjeshtë do të kemi emërimet në këtë gjykatë. Kur them në vjeshtë, mendoj se në shtator do të jemi gati që të kemi Gjykatën e Lartë dhe emërimet e para në Gjykatën e Lartë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Llagami!

Fjalën e ka kërkuar zonja Hysi për pyetje.

Vetëm do t'ju lutesha që pyetjet të jenë koncize, por edhe përgjigjet të jenë sa më të shkurtra për të pasur mundësinë të gjithë kolegët, që kanë pyetje, të marrin përgjigje.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Llagami, për raportin!

Më lejoni të shpreh konsideratën për këtë raport, i cili është shumë i detajuar jo vetëm për veprimtari e ish-KLD-së, por edhe për veprimtarinë tuaj për një periudhë shumë të shkurtër, si dhe për gjendjen e sistemit gjyqësor. Kam edhe një sugjerim: nuk duhej të prisnit raportimin në Kuvendin e Shqipërisë që publiku të njihej me ato që ka bërë KLGJ-ja. Domethënë, ka vend për më shumë komunikime me publikun dhe transparencë, pasi keni bërë një punë kolosale, të cilën edhe ne si deputetë duhej ta mësonim kur të merrnim raportin. Kjo është një vërejtje, por edhe një sugjerim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino, po flas për vete.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam disa pyetje. Pyetja e parë ka të bëjë me vlerësimin e subjekteve që i nënshtrohen vetingut. Cila është marrëdhënia juaj me Komisionin e Kualifikimit? Sipas raportit, keni dërguar dosjet për 76 subjekte të rivlerësimit kalimtar, pra keni hedhur shortet, dhe 159 subjekte janë në proces. Cilat janë kriteret e përzgjedhjes së subjekteve, pra si përzgjidhen subjektet?

Pyetja e dytë ka të bëjë me Gjykatën e Posaçme. Në raport ju thoni se për Gjykatën e Posaçme, për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve, kanë aplikuar 14 gjyqtarë nga 15 për Shkallën e Parë dhe për Gjykatën Apelit kanë dhënë pëlqimin 8 gjyqtarë. Kur mendohet të ngrihet kjo gjykatë, qoftë Gjykata e Shkallës së Parë, qoftë Gjykata e Apelit?

Së treti, dëgjova me vëmendje dhe të them të drejtën çështja e tarifave gjyqësore është shumë e drejtë! Ne kemi miratuar një ligj, në kuadër të reformës në drejtësi, dhe një nga shqetësimet është futja e tarifave të reja. Në çfarë faze jeni, në komunikim edhe me Ministrinë e Drejtësisë dhe me Ministrinë e Financave, sepse besoj se ju keni një peshë të rëndësishme?

Së katërti, është ligji për ndihmën juridike: pa dyshim, janë një sërë aktesh nënligjore që duhet t'i nxjerrë Ministria e Drejtësisë, megjithatë ju, si një Këshill, që bëni vlerësimin e punës së gjyqtarëve dhe efektin e punës së reformës në drejtësi, keni të drejtësi të shprehni opinione dhe vlerësime lidhur me ecurinë e zbatimit të këtyre ligjeve të reja të reformës në

drejtësi. Në lidhje me ndihmën juridike, a keni ndonjë informacion nga vlerësimet, që po bëni në lidhje me ndikimin ose me problemet që po nxjerr zbatimi i këtij ligji në praktikë?

Me shumë të drejtë ngritët shqetësim për çështjet, që kanë mbetur ende pa u shqyrtuar dhe janë depozituar, nuk flas vetëm për Gjykatën e Lartë, por edhe për gjykatat e tjera. A keni ndonjë vlerësim të paktën, me gjithë morinë e numrit të akteve dhe të ngarkesës, që është e jashtëzakonshme, lidhur me zgjidhjet jashtëgjyqësore të shumë konflikteve? Pra, a keni nxjerrë ndonjë akt, ndonjë udhëtim të karakterit të përgjithshëm për të ulur ngarkesën dhe për të filluar zbatimin e instituteve të reja që kanë parashikuar, qoftë Kodi Civil, qoftë Kodi i Procedurës Civile, qoftë Kodi i Procedurës Penale për zgjidhjen me ndërmjetësim të konflikteve, për të cilat nuk ka nevojë të shkohet në gjykatë, në këtë mënyrë ulet mbingarkesa e gjyqtarëve?

Së fundi, nuk dua të marr fjalën për diskutim, zoti kryetar.

Duke qenë se keni pasur një ngarkesë të jashtëzakonshme dhe të larmishme, jo thjesht miratim aktesh normative, por edhe plotësim të vakancave dhe përgjigje të menjëhershme për problemet që krijohen, edhe një herë, dua ta theksoj, dhe këtë e kam në emrin tim që të mos keqkuptohet zot Fino, se duhet më shumë transparencë për publikun dhe për gjithçka që është bërë për të sqaruar se çfarë po bëhet për Gjykatën e Lartë, për Gjykatën e Posaçme, por edhe për një sërë institucionesh të tjera. Reforma në drejtësi nuk është vetëm vetingu, por ka edhe shumë aspekte të tjera, për të cilat qytetarët kanë nevojë të mësojnë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Urdhëroni, zonja kryetare!

Ju lutem, në mënyrë të përmbledhur përgjigjet e pyetjeve.

Naureda Llagami – E pranoj me shumë të drejtë sugjerimin e zonjës Hysi për sa i përket transparencës së Këshillit. Me thënë të vërtetën, ne jemi munduar që të veprojmë në një kohë shumë të ngarkuar dhe në një kohë shumë të ngjeshur që të kemi vendimmarrje. Të paktën në mbledhjet që ne kemi zhvilluar kujtudo, që ka paraqitur një kërkesë për të qenë prezent në atë mbledhje, ia kemi lejuar që të jetë prezent, duke përfshirë shoqërinë civile, individët që kanë interes, ashtu edhe medien. Pra, nuk kemi kufizuar asnjë që të jetë prezent në çështje që kemi pasur për shqyrtim dhe për debat në mbledhjet tona.

Megjithatë, dua t'ju informoj se Këshilli ka caktuar anëtarin e tij për komunikimin me medien, i cili aktualisht po zhvillon një strategji të komunikimit me medien dhe shumë shpejt Këshilli do të dalë me strategjinë dhe me një komunikim ndryshe me publikun.

Një mangësi që kemi për momentin, është *website*-i ynë. *Website*-i ynë është i trashëguar dhe nuk na lejon të jemi në nivelin e transparencës që duam dhe, nga ana tjetër, të

pasqyrojmë atë punë që ju, me të drejtë, thatë që kemi bërë. Nuk janë pak 101 vendimmarrje dhe, për hir të së vërtetës, ato vendimmarrje janë të pasqyruara, por mënyra se si kërkohen në atë *website* lë për të dëshiruar. Shumë shpejt, me mbështetjen e USAID-it dhe të projektit “*Justice for all*”, Këshilli i Lartë Gjyqësor do të lançojë *website*-in e ri, ku pa diskutim që informacioni do të jetë i organizuar, publiku do të ketë mundësi të ketë më shumë akses në informacion dhe transparenca do të garantohet ashtu siç duhet, duke përfshirë edhe strategjinë e komunikimit përmes anëtarit që kemi caktuar për këtë gjë. Besoj se kjo situatë do të zgjidhet shumë shpejt, por e vlerësoj shumë si koment, sepse është një nga gjërat që na ka çeduar në këta 6 muaj të ekzistencës sonë.

Për sa i përket procesit të vetingut, për t’ju informuar edhe një herë në lidhje me emrat e subjekteve, për të cilat Këshilli bën vlerësimin, Këshilli bën vlerësimin përmes komisionit. Është KPK-ja që na orienton se me cilin do të fillohet vlerësimi profesional. KPK-ja hedh shortet, pas hedhjes së shorteve, anëtarët e komisionit të posaçëm, që merren me vlerësimin, shkojnë në gjykata dhe hedhin shortet për dosjet gjyqësore. Pasi hedhin shortet për dosjet gjyqësore në gjykatat respektive të gjyqtarëve (sikurse e dini, në bazë të ligjit, duhet të merren 5 dokumente ligjore dhe merren 5 dosje gjyqësore), më pas merren dosjet gjyqësore nga gjykatat, për të cilat ka rënë shorti. Në momentin kur merren këto dosje gjyqësore, fillon përpunimi i raportit, i cili më pas, në një kohë shumë të shpejtë, u përcillet organeve të vetingut. Pra, shorti i subjekteve, që kalojnë për veting, hidhet nga organet e vetingut. Këshilli merr përsipër hedhjen e shortit të dosjeve gjyqësore për subjektet që kanë vendosur ato me short t’i nënshtrohen me përparësi procesit të vetingut.

Në lidhje me gjykatat e posaçme, dua që t’ju sqaroj diçka: Këshilli nuk ka asnjë pengesë për ta ngritur Gjykatën e Posaçme sa më shpejt të jetë e mundur, pasi kuadri ligjor e lejon Këshillin që gjyqtarët, të cilët aktualisht janë në Gjykatën e Krimeve të Rënda (mjafton të japin pëlqimin), mund të kalojnë automatikisht në një caktim të përkohshëm të këto gjykata të posaçme, edhe pa iu nënshtruar procesit të vetingut. Ajo që ne kemi gjykuar si të domosdoshme, është të jemi në koordinim me Këshillin e Prokurorisë, ngaqë nuk mund të caktojmë gjykatën nëse nuk kemi të caktuar prokurorinë, sepse ajo gjykatë që ne caktojmë ngelet pa lëndë gjykimi. Në situatën ku ndodhet sistemi ynë gjyqësor, ne nuk e kemi luksin të lemë një gjykatë pa lëndë gjykimi dhe në këtë mënyrë të cenojnë gjithë objektin e veprave që gjykon aktualisht Gjykata e Krimeve të Rënda.

Për këtë arsye kemi menduar se, në momentin që Këshilli i Prokurorisë është gati të caktojë prokurorët, pra të bëjë edhe emërimet e SPAK-ut, automatikisht jemi në të njëjtën kohë, koordinojmë me Këshillin e Prokurorisë.

Në lidhje me çështjen e tarifave gjyqësore, ju e dini se në këshill jam përfaqësuese e shoqërisë civile. Kuadri ligjor i ndihmës juridike dhe i tarifave gjyqësore është një nga gjërat ndaj së cilës kam ndjeshmëri mbase më të lartë se anëtarët e tjerë. Jo më kot, me të filluar punën në këtë institucion, çështja e parë që mora për trajtim ishte përcaktimi i tarifave gjyqësore. Sepse, është shumë e rëndësishme që brenda kuadrit nënligjor për ligjin e ndihmës juridike, kuadër i cili pritet të miratohet nga Ministria e Drejtësisë, ne të veprojmë paralelisht me tarifën, me propozimin për tarifa gjyqësore, përfshirë llojin e tarifës dhe proporcionalitetin.

Grupi i punës, me asistencën e dy projekteve që ka këshilli, përfshirë EURALIUS-in dhe Drejtësi për të gjithë, nga USAID-i, ka bërë një studim shumë dinjitoz lidhur me këto tarifa gjyqësore, duke përjashtuar, pra duke tarifuar zero gjithë grupin e çështjeve, për të cilat ligji kërkon ofrimin e ndihmës juridike. Kuptohet, ky është një sensitivitet që kryetarja e ka, por ka gjetur po ashtu gjithë vullnetin e anëtarëve të këshillit, si dhe të grupit të punës.

Në çfarë faze është këshilli? Unë jua thashë: ne ia kemi çuar këtë propozim Ministrisë së Drejtësisë. Në këto momente jemi duke koordinuar me Ministrinë e Drejtësisë lidhur me propozimin e çuar, dhe besoj se shumë shpejt do të kemi një udhëzim për këto tarifa gjyqësore, duke bërë të mundur edhe aplikimin e skemës së ndihmës juridike.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Naureda Llagami – Për sa i përket ndërmjetësimit, kuptohet që jemi sensitivë edhe në lidhje me këtë çështje, por në objektivat tanë afatshkurtër ndërmjetësimi është diçka e cila, edhe në kuadrin ligjor nuk është pjesë e detyrimit të gjykatës në kuptimin e mirëfilltë. Me mbështetjen e ndërkombëtarëve dhe me mbështetjen e projekteve, ne donim ta promovonim sa më shumë ndërmjetësimin në gjykatë. Do të jetë pjesë e planit tonë strategjik për ta reflektuar dhe për ta promovuar këtë si mjet alternativ.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa i takon ndihmës juridike, nga një kontakt që kam pasur me Ministrinë e Drejtësisë, është e pritshme që së shpejti të zgjidhet drejtori i drejtorisë përkatëse të ndihmës juridike, përmes të cilit mund të ngremë ura bashkëpunimi për problematikat në gjykatë dhe aplikimin e të drejtës së saj.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Llagami!

Kush ka pyetje të tjera?

Po, zonja Xhina. Pastaj zonja Mara.

Elena Xhina – Faleminderit, zoti kryetar!

Ju falënderoj për raportimin dhe për panoramën në lidhje me sistemin gjyqësor në Shqipëri, për të cilën dihet se nuk i ka të pakta problematikat.

Pyetja ime ka të bëjë me një pikë të raportit, që ju nuk e keni pasqyruar: me arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

Dimë plot raste kur qytetarët enden dyerve të gjykatave, pasi nuk mund të marrin dot vendimet e zbardhura, duke u cenuar kështu një nga kërkesat kryesore të procesit të rregullt ligjor, pasi ka vonesa në dorëzimin e dosjeve gjyqësore.

Di që nga ana juaj po bëhet përpjekje të hidhen hapat e duhur, për t'u ardhur në ndihmë këtyre gjykatave, pasi efektet e mosdorëzimit të dosjeve janë të rënda për qytetarët. Në lidhje me emërimin e ndihmësve ligjorë apo të ndonjë stafi tjetër të ndihmës nga ana juaj, çfarë hapash po ndërmerren për lehtësimin e punës së gjykatave, sidomos të atyre të shkallëve të para, por dhe për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve, që ata t'i marrin sa më shpejt vendimet e zbardhura nga gjyqtarët?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

Zonja Llagami, fjala për ju!

Naureda Llagami – Çështja e arsyetimit të vendimeve në kohë është shumë e rëndësishme dhe përbën një komponent, të cilin e kemi pjesë të vlerësimit profesional për gjyqtarët. Pra, një nga indikatorët për vlerësimin e gjyqtarëve në të ardhmen do të jetë pikërisht ai që ka të bëjë me afatet kohore, brenda të cilëve ata do të dorëzojnë vendimet gjyqësore.

Pa diskutim që sot gjykatat janë të ngarkuara, dhe çështja që ju shtruat është një nga prioritetet e këshillit, pra pajisja e gjykatave me staf ndihmës. Kuptohet, kjo është edhe çështje buxheti.

Po ta lexoni deri në fund, te propozimet apo kërkesat që unë kam ndaj Kuvendit, një nga kërkesat që kam parashtruar është shtimi i stafit për sistemin gjyqësor. Në fakt, ne kemi kërkuar të marrim 150 punonjës staf ndihmës, ndërkohë që, për të pasur një gjyqësor eficient, ashtu siç do të donim ta kishim, na duhen 333 punonjës.

Me kuadrin e ri ligjor është parashikuar që të gjitha gjykatat e apelit të kenë ndihmësa ligjorë. Pra, në momentin kur ne do të kemi një bazë të caktuar burimesh njerëzore, miratim numri, e nga ana tjetër edhe buxheti, pa diskutim që do të vijojmë me rekrutimin, gjë për të cilën ligji ka përcaktuar kritere. Jo më larg se para gjashtë muajsh kemi propozuar që në shkollën e magistraturës të hapen konkurse për ndihmësa ligjorë dhe këshilltarë ligjorë. Jemi

duke menduar se si do të procedojmë për shtimin e stafit ndihmës të gjykatës. Kuptohet, këto janë çështje të limituara brenda buxhetit që ka Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Zonja Mara ka fjalën për të bërë pyetje.

Aurora Mara – Faleminderit, kryetar!

Zonja kryetare, unë ju përgëzoj për raportin, që është një raport shumë i saktë, si dhe për punën e bërë. Duhet të kemi parasysh edhe faktin se jeni organ i ri, se keni vështirësi që lidhen edhe me reformën në drejtësi, të cilat i bashkëngjiten njëra-tjetrës.

Të them të drejtën, unë kisha vetëm një pyetje, shkurtimisht. Duke parë numrin e çështjeve stok, që janë të mbartura, mendoj se numri i stokut nuk është krijuar ditët e fundit apo muajt e fundit të strukturimit të organit tuaj, gjë që më bën të kuptoj se reforma në drejtësi ka qenë e domosdoshme. Dua të di vetëm diçka: a keni realizuar apo a keni menduar një strategji emergjente në lidhje me trajtimin e këtyre çështjeve stok sipas mënyrës së ndarjes në bazë të personave që tashmë keni në gjykatë, që janë nëpunës të gjykatës apo gjyqtarë; pra, të bëhet ndarja e çështjeve, në mënyrë që të evitohet këtë stokun e madh të çështjeve në vazhdim. Unë e kuptoj se ju jeni për krijimin e një sistemi për t'i menaxhuar çështjet stok, për ngritjen e një sistemi të ri e të unifikuar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, siç e keni cilësuar edhe në raportin tuaj, por mbase një ndarje emergjente do të ishte e domosdoshme për momentin.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Mara!

Zonja Llagami.

Naureda Llagami – Në fakt, problemi i çështjeve të prapambetura, sikundër u mundova ta sqaroj, është një fenomen i izoluar në Gjykatën e Lartë. Sa u takon gjykatave të tjera, sikurse jua thashë, pra sa i takon sistemit tjetër, gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, ne kemi një normë evadimi të çështjeve 100, 1, që do të thotë se jemi në ritme shumë të mira. Pra, gjithë problemin e kemi me Gjykatën e Lartë.

Ju e përmendët me të drejtë. Nuk është një situatë që ka ndodhur brenda 24 orëve e as brenda një viti, por të gjithë e dimë se është krijuar prej vitesh. Pra, është një situatë, e cila ka ardhur që nga mungesa e vullnetit për të emëruar anëtarët në Gjykatën e Lartë, gjë që ka krijuar edhe stokun që kemi sot. Pa diskutim që këshilli është në proces shqyrtimi në lidhje me mënyrën e adresimit të stokut që ekziston në Gjykatën e Lartë.

Sikurse e dimë, kuadri ligjor i lejon këshillit mundësinë që, përmes hartës gjyqësore të bëjë edhe rishikimin e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, por ky është një proces që ne

do ta vlerësojmë në kuadër të miratimit të hartës gjyqësore dhe nevojës për numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë.

Ajo që këshilli kërkon të bëjë në mënyrë imediate, është plotësimi i vendeve vakante në Gjykatën e Lartë. Aktualisht, me ligj, vendet vakante në Gjykatën e Lartë janë nëntëmbëdhjetë. Me plotësimin e këtyre vendeve, ju garantoj se stoku do të ulet ndjeshëm. Sepse, për hir të së vërtetës, deri më tani, Gjykata e Lartë nuk ka qenë kurrë me vendet vakante të plotësuara tërësisht.

Ne jemi besimplotë se në momentin kur vendet vakante të plotësohen, mund të kemi një rënie goxha të ndjeshme të stokut, por nga ana tjetër do të jemi edhe në procesin e rivlerësimit të konfigurimit të hartës gjyqësore, pra të burimeve njerëzore, të burimeve infrastrukturore, që do të na lehtësojnë mundësinë për të shkuar drejt një sistemi gjyqësor më eficient.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Kush ka pyetje të tjera?

Po, zoti Fino!

Bashkim Fino – Zonja Llagami, dëshira juaj e mirë për të bërë një raport të saktë, do të thosha unë, le të jetë si udhërrëfyese edhe për raporte të tjera, që ju do të sillni në parlament, sepse ky është raporti i parë. Pra, të mos jetë i vetmi kaq i mirë ky raport i parë, për të cilin morët vlerësime nga kolegët, sepse ju e keni për detyrë të raportoni dy herë në vit në Kuvend.

Unë dua të bëj dy pyetje për publikun, që ta kuptojë edhe publiku se ky është një organ i ri i krijuar, dhe është qeveria e gjyqësorit.

Me të drejtë, ju shkruani në raport se gjendja në 2018-ën ka qenë e keqe. Këtë e dinim edhe ne, prandaj i krijuam këto struktura të reja. Reforma në sistemin e drejtësisë u projektua duke mbajtur parasysh deformimet që kishte sistemi, duke synuar të adresoheshin në mënyrë sistematike praktikat komprometuese, pandëshkueshmëria, mungesa e transparencës e të tjera me radhë.

Pyetja që unë kam, duke e konsideruar KLGJ-në si një nga organet e reja të drejtësisë, është: a i ka shërbyer veprimtaria e deritanishme, për aq kohë sa keni që jeni krijuar, gjashtë muaj siç thatë ju, rritjes së transparencës dhe rikthimit të besimit të publikut te gjyqësori? Si e konceptoni ju si këshill, dhe vetë ju si kryetare, në këtë kohë të shkurtër? Sepse, perceptimi pozitiv fillon që nga publiku, do të thotë se do të kemi pritshmëri akoma më të larta.

Kjo është një pyetje që i takon publikut.

Pyetja ime e dytë ka të bëjë me... Pyeti edhe zonja nënkryetare e Kuvendit, por unë nuk e kam në kuptimin nëse janë krijuar apo jo gjykatat e posaçme. Nuk e kam në kuptimin nëse

janë krijuar apo jo. Se ju u përgjigjët shumë saktë. Unë e kam nga një këndvështrim tjetër. Që të krijohet Gjykata e Posaçme duhet të shprehë interes me shkrim ai që është gjyqtar apo prokuror, se do që të jetë. E dyta, që familjarët e tij e japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive bankare apo edhe të telekomunikimeve vetiake e të tjera me radhë.

Pyetja që unë kam është: çfarë ka ndodhur me gjyqtarët që nuk e kanë dhënë këtë pëlqim? Se mund të ketë gjyqtarë që nuk e kanë dhënë këtë pëlqim. Janë transferuar apo vazhdojnë t'i ushtrojnë detyrat si gjyqtarë të një gjykate, gjë të cilën ligji e ndalon? Domethënë, do të ishte e turpshme nëse unë nuk e kam dhënë pëlqimin si gjyqtar, por vazhdoj të gjykoj në këto gjykata çështje që nuk më takon të gjykoj. Kjo është një çështje, në lidhje me të cilën duhet t'i vini pikat mbi 'i'. Ekzistojnë raste të kësaj natyre, ndaj ju duhet të merreni edhe me to.

Pyetja e fundit që kam, ka të bëjë edhe me ne, zoti kryetar, dhe ju anëtarë të Komisionit të Ligjeve! Ne kemi qenë të parët që i kemi mbështetur kërkesat tuaja si KLGJ. Komisioni i Ligjeve dhe Kuvendi i Shqipërisë ju ka miratuar një strukturë, në lidhje me të cilën kemi bërë diskutime e debate për të mirën e punës.

Pyetja që kam sot, sepse do të vijë puna prapë në fund të vitit, në lidhje me projekt-buxhetin, është: sa për qind e strukturës suaj është e mbuluar sot, e mbushur, le të themi, dhe sa është efektive në rastin konkret, gjatë këtyre gjashtë muajve, kohë gjatë së cilës ne si parlament ju kemi plotësuar të gjitha kërkesat, që kanë të bëjnë me strukturën organizative e me fondet përkatëse?

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Fino!

Zonja Llagami.

Naureda Llagami - Në lidhje me çështjen e publikut, është shumë e drejtë nëse ngrihet pyetja, a i kapim pritshmëritë e publikut në drejtim të besimit që kanë ndaj sistemit? KLGJ-ja ka vetëm 6 muaj ekzistencë dhe vendimmarrjet e kësaj të fundit janë në proces dhe ato më të rëndësishmet do të vijojnë të vijnë në proces. Unë nuk e kam një perceptim të saktë se çfarë mendon publiku për këtë gjë, pasi besoj se kjo është një çështje e së ardhmes, sepse 6 muaj, për mendim tim, janë shumë pak që të kemi një reagim nga publiku. Por besoj se brenda një viti, ndoshta te raportimi tjetër do të jem gati t'ju them se nëpërmjet mekanizmave dhe instrumenteve që do të krijojmë do të mundësojmë në *website*-in perceptimin që do të ketë publiku për veprimtarinë e KLGJ-së. Pra, për 6 muaj e kemi ende të pamundur të shprehemi se çfarë perceptimi ka publiku lidhur me veprimtarinë dhe funksionalitetin e KLGJ-së.

Për sa i përket çështjes së krijimit të Gjykatës së Posaçme, po t'i referohem ligjit, ai ka vendosur një mekanizëm në shprehjen e vullnetit të atyre që janë gjyqtarë në Gjykatën e Krimeve të Rënda për të kaluar në Gjykatën e Posaçme, që do të thotë se ky lloj mekanizmi nuk ka pasoja për ata, nëse vlerësojnë dhe vendosin të shkojnë në atë gjykatë. Është një mekanizëm, që nëse çdo individ apo gjyqtar që është pjesë e trupës gjyqësore të Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe jep pëlqimin të kalojë në Gjykatën e Posaçme nuk ka asnjë pengesë të kalojë, ashtu sikurse nuk ka asnjë masë që ai të mos kalojë. Ai do të jetë pjesë e trupës gjyqësore, e sistemit gjyqësor dhe do të caktohet në një gjykatë tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sikurse ju njoftova nuk e kemi ngritur Gjykatën e Posaçme dhe nuk mundet që një person pa dhënë pëlqimin të shkojë në Gjykatën e Posaçme. Ata që do të shkojnë në këtë gjykatë do të jenë vetëm ata që kanë dhënë pëlqimin. Ajo do të ngrihet në momentin që do të ngrihet Prokuroria e Posaçme.

Për sa i përket strukturës, ju bëj me dije se me miratimin e buxhetit dhe të numrit të përgjithshëm të punonjësve, struktura e Këshillit të Lartë Gjyqësor në krahasim me strukturën e organit pararendës është shtuar 30%. Aktualisht Këshilli po reflekton strukturën e re që ka miratuar lidhur me akomodimin e të gjithë punonjësve që punojnë në atë Këshill dhe me rekrutimin e stafit të ri, i cili do të mundësojë edhe rritjen e performancës së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ulsi Manja - Ka pyetje të tjera?

Po, zoti Braho.

Spartak Braho – Ju shprehët një problematikë që lidhet me stafin ndihmës. Siç e kuptova, apo ndoshta nuk e kam dëgjuar saktë, keni nevojë edhe për 300 personel apo për

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Doni të rinj 330? Sa janë: 300 apo 150?

Naureda Llagami - Për saktësi, për të mbuluar nevojat e të gjithë sistemit gjyqësor për 38 gjykatat në Republikën e Shqipërisë kemi thënë se për një periudhë 3 –vjeçare kërkojmë 330 punonjës, duke i kërkuar Kuvendit që në vitin pasardhës të na miratojë 150 punonjës shtesë për të gjithë sistemin gjyqësor, për të gjitha gjykatat.

Spartak Braho - Sa është kostoja e tyre? Nuk e thoni dot. Si e mendoni rrugën e zgjidhjes, përveç kërkesës në fund të vitit për shtesa në buxhet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Naureda Llagami - Në planin tonë strategjik kemi thënë se për të pasur gjykata ekselente është një nga konceptet e reja që kemi futur në planin tonë strategjik për gjykata sa

më të mira dhe një sistem sa më të mirë, pa diskutim që kërkohen burime njerëzore dhe infrastrukturore. Në vlerësimin që kemi bërë në këtë plan strategjik dhe në planbuxhet, jemi shprehur se nëse duam të rrisim cilësinë e shërbimit, na nevojiten 150...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo çështje është në diskrecionin e Kuvendit dhe jo të KLGJ-së.

Ulsi Manja – Ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka. Ka diskutime? Nuk ka.

Faleminderit, zonja Llagami për raportimin!

Falënderoj edhe kolegët për pyetjet, të cilat i dhanë mundësi publikut për të marrë edhe lajme të mira nga ky raportim. Është raportimi i parë në Kuvend si detyrim i nenit 82 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe si çdo shtëpi e re në 6 muaj edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor ka problematikat e tij, por edhe unë bashkohem me mendimin e kolegëve për të gjithë punën e KLGJ-së në kaq pak muaj. Nuk janë pak 101 vendimmarrje të tij. Sot morëm edhe lajme të mira për opinionin publik. Është gati Gjykata e Posaçme me 22 gjyqtarë që kanë shprehur pëlqimin dhe në momentin e krijimit të Prokurorisë së Posaçme paralelisht do të fillojë punë edhe Gjykata e Posaçme, të shpresojmë në muajin shtator.

Lajmi i dytë i mirë është hapja e garës së aplikimeve për anëtarët e Gjykatës së Lartë. Një e pesta do të vijnë nga radhët e juristëve të spikatur, sepse brenda sistemit nuk pengohet asnjë gjyqtar për të konkurruar për të qenë pjesë e trupës së Gjykatës së Lartë. Me rolin e ri që ka kjo e fundit sipas ligjeve të reja të reformës edhe roli i Gjykatës së Lartë ka ndryshuar, ka një dimension të ri të natyrës së gjykimit në Gjykatën e Lartë. Unë shpresoj se në momentin që trupat e para do të fillojnë në kolegjet e Gjykatës së Lartë numri prej 31 mijë çështjesh, do të reduktohet ndjeshëm. Shifra që u dha për vitin 2018 ku vetëm një trupë gjykuese me 3 gjyqtarë ka arritur të evadojë 1600 çështje, më bën të mendoj se dy trupa gjykuese në Gjykatën e Lartë mund të ecin me ritmin e duhur, sepse natyra e gjykimit në Gjykatën e Lartë ka ndryshuar sipas ligjit: drejtësia jepet në Shkallën e Parë dhe merr formë të prerë në Apel, ndërsa roli i Gjykatës së Lartë është zbatimi i ligjit. Edhe ky është një lajm i mirë që shumë shpejt në muajin shtator do të kemi funksionimin e Gjykatës së Lartë.

Duhet të përshëndetet dhe fillimi i punës për hartimin e hartës gjyqësore, sepse është shumë i rëndësishëm hartimi i hartës gjyqësore, siç është lajm i mirë që në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit për shkak të skemës së delegimit që po aplikon KLGJ-ja nuk kemi bllokim të dhënies së drejtësisë për qytetarët, kjo është shumë e rëndësishme.

Unë nuk do të zgjatem më tepër, por do të bashkohem me vërejtjen miqësore që bënë kolegët për të rritur transparencën me publikun. Ju jeni qeveria e re e gjyqësorit, jeni organi i ri i sistemit të drejtësisë dhe nëse ju do të komunikoni si duhet me publikun me këtë punë

që keni bërë për 6 muaj, do të na e kishit hequr barrën edhe në të politikës që japim padrejtësisht llogari edhe për punën e dy qeverive: qeverisë së gjyqësorit dhe asaj të prokurorisë. Sistemi tashmë ka qeverinë e tij, ju keni bërë goxha punë dhe nuk ka pse opinionin publik të marrë përgjigjen nga ne dhe as politika se kur do të kemi Gjykatë të Lartë dhe kur do të kemi Gjykatë të Posaçme. Është detyra juaj që t'ia transmetoni këtë shqetësim publikut.

Nuk e di sesi e keni menduar strategjinë e komunikimit me publikun, por nga raportimi i sotëm në komision, përpos gjithë kësaj pune të mirë që keni bërë dhe 3-4 lajmeve të mira që mori opinionin publik, duhet të ndërtoni një strategji të re të komunikimit me publikun.

Mediet sot i kemi prezente dhe si çdo ditë transmetojnë punën e Komisionit të Ligjeve, duhet që edhe ju të bëni të njëjtën gjë.

Dua të falënderoj mediet, posaçërisht sot për interesin në këtë seancë dëgjimore. Ndoshta ka qenë ndër seancat dëgjimore, ku interesi i medieve ka qenë i shtuar, sepse ju e kuptoni që zbatimi i reformës në drejtësi që në ditën e parë të krijimit të Komisionit të Posaçëm dhe deri më sot vazhdon të jetë në fokusin kryesor të medieve, por edhe të opinionit publik.

Faleminderit, zonja Llagami, zoti Toska dhe zonja Skënderi!

Ditë të mbarë!

Relatori dhe këshilltarët do të bëjnë gati edhe rezolutën për Kuvendin, ku do të gjejnë pasqyrim jo vetëm ato që raportuat, por edhe rekomandimet që ka Kuvendi për institucionin që drejtoni.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.07.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Vazhdimi i shqyrtimit nen për nen të projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Damian Gjikhuri, Edmond Leka, Bashkim Fino, Elena Xhina, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Ediola Braha, Alban Zeneli, Andi Permeti dhe Edlira Bode.

Mungojnë:

Fatmir Xhafaj, Alket Hyseni, Elda Hoti dhe Tom Doshi

Ulsi Manja - Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës që është vazhdim i shqyrtimit nën për nen të projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”. Komisioni ynë është komisioni përgjegjës. Relatore është kolegja Hysi.

Në fakt, ne e kemi nisur shqyrtimin dhe miratimin nën për nen të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë. Nuk e di zonja Hysi, se në cilin nen e kemi ndërprerë për ta vazhduar sot diskutimin dhe miratimin e Rregullores, në mos gaboj jemi te neni 9?

Vasilika Hysi - Zoti kryetar, ne kemi kaluar disa nene, por kemi lënë edhe nene të hapura. Nëse ju bini dakord që neneve të hapura t’u kthehemi në fund, mund të vazhdojmë me nenet e lëna në vijimësi.

Ulsi Manja - Zonja Hysi do të ndjekim të njëjtën metodë pune, me shqyrtimin dhe miratimin e neneve të Rregullores. Për ato nene që janë ende në diskutim e sipër jo vetëm në grupin e punës me deputetët pjesë e këtij grupi, por edhe me deputetët e tjerë të Kuvendit të Shqipërisë që kanë interes për t’u përfshirë në shqyrtimin dhe në miratimin e neneve të reja të Rregullores, t’i lëmë të hapura, për t’iu rikthyer në fund, përpara votimit në tërësi. Të vazhdojmë me ato nene që ju i keni mbyllur dhe i keni dakordësuar për t’i votuar nën për nen.

Vasilika Hysi - Dakord.

Në rast se ju kujtohet, zonja Xhina bëri një sugjerim për të pasur një rregullim të statusit të deputetëve të pavarur ose të deputetëve jashtë grupeve parlamentare.

Të nderuar kolegë, pas nenit 17 shtohet neni 17/1 me një përmbajtje që ju e keni përpara. “Deputeti i pavarur dhe/ose deputeti jashtë grupeve parlamentare, merr pjesë në komisionet e përhershme, në nënkomisionet, në komisionet hetimore ose të posaçme me kërkesë të tij dhe me miratim të Kryetarit të Kuvendit”, paragrafi i parë. “Deputeti i pavarur dhe/ose deputeti jashtë grupeve parlamentare, ka të drejtë të marrë pjesë në grupet e miqësisë dhe në delegacionet e përkohshme. Anëtarësia në grupet e miqësisë bëhet në bazë të përzgjedhjes së deputetit dhe me miratim të Kryetarit të Kuvendit, kurse pjesëmarrja në delegacionet e përkohshme bëhet me caktim të Kryetarit të Kuvendit”.

Neni 13 i projektligjit shton nenin 17/1. Besoj se rekomandimi që bëri kolegja Xhina ka gjetur rregullin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino, unë ju falënderoj për pyetjen që bëtë! Çdo deputet ka të drejtë të jetë, por nga ana tjetër në Rregullore kemi një nen, që thotë se përbërja e komisioneve mban për aq sa është e mundur përkatësinë mes shumicës dhe pakicës. Përderisa përbërja e komisionit përcaktohet duke pasur parasysh përbërjen sa të jetë e mundur të shumicës dhe të pakicës ka një kategori

deputetësh, të cilët në këtë sesion parlamentar janë më të shumtë edhe si të pavarur, edhe jashtë grupeve parlamentare. Shqetësimi i zonjës Xhina është shumë i drejtë, si do të ndahen këta deputetë? Pra, në nenin 20, ku flitet për anëtarësinë në komisionet e përhershme, në komisionet e përhershme marrin pjesë të gjithë deputetët, për aq sa pasqyrohet grupi parlamentar, ndërsa për deputetët që nuk kanë grup parlamentar dikush duhet ta rregullojë këtë status. Ky propozim është në përgjigje të rekomandimit të ngritur nga zonja Xhina.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E bëme nen të veçantë.

Ulsi Manja – Ju lutem!

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Ideja është: jemi në pjesën ku rregullohen grupet parlamentare. Teorikisht, shumica e deputetëve janë nëpër grupe, por mund të ketë një kontingjent deputetësh, siç dhe ka dhe mund të ketë edhe në vijimësi, që nuk janë në grupe. Atëherë këta do të lihen pa rregulluar? Jo.

Përveç parimeve të përgjithshme që deputeti prezumohet, kur jemi duke përcaktuar grupet dhe themi që grupet përcaktojnë se kush do të jetë këtu e kush atje, le të rregullojmë edhe pjesën tjetër në mënyrë të veçantë, se vetëm mirë do jetë.

Ulsi Manja – Po, zoti Braho.

Spartak Braho – Unë jam dakord me këtë formulim, por më duket sikur i kemi vënë vetes qëllim vetëm për t'i caktuar në grupet e miqësisë. Paragrafi i parë nuk thotë gjë, kështu që ne duhet të shtojmë që përveç se merr pjesë në grupet e miqësisë edhe në aktivitete të tjera parlamentare, në komisionet hetimore...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë atëherë, tërhiqem.

Ulsi Manja – Ju lutem, zonja Hysi, këtu është neni 12/1 që ndryshon nenin 17 dhe shton nenin 17/1 me përmbajtjen: “Deputeti i pavarur dhe/ose deputeti jashtë grupeve parlamentare...”. Me këtë formulim është rënë dakord dhe më duket se thjesht keni reflektuar një situatë që është *de facto* në Kuvend dhe që është rast i rrallë, shpresojmë të mos ndodhë herë të tjera, pasi qëllimi i Rregullores është të pozicionojë deputetët në grupe, por nëse je deputet nuk ta mohon askush të jesh pjesë e komisioneve të përhershme, e komisioneve hetimore, e komisioneve të posaçme e as e delegacioneve. Megjithatë, fakti që e keni bërë në rregullore, keni bërë mirë.

E hedhim në votim.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Patjetër që do ta falënderojmë zonjën Xhina si propozuese e këtij neni të Rregullores. Relatorja e ka pranuar propozimin tuaj.

Kalojmë te neni 13, që është rekomandim i IPA-s.

Vasilika Hysi – Neni 13 synon të ndryshojë nenin 18, që bën fjalë për kompetencat e komisioneve të përhershme. Ka një shtesë në paragrafin e dytë me përmbajtje si më poshtë:

“Në fund të çdo viti kalendarik komisionet e përhershme paraqesin raportin vjetor të veprimtarive të tyre parlamentare në një seancë plenare të veçantë. Raporti nuk është objekt diskutimi, me përjashtim të rasteve kur Konferenca e Kryetarëve vendos ndryshe”. Ky është rekomandim i projektit IPA, që synon të rrisë transparencën e komisioneve. Ndërkohë që kjo veprimtari bëhet në Kuvendin e Shqipërisë, por nuk ka qenë e rregulluar.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Dakord.

Tani, ideja e rekomandimit të IPA-s është qëstatistikat narrative që komisionet e përhershme miratojnë në fund të vitit lidhur me procesin e ligjvënës, të kontrollit parlamentar dhe të funksionit zgjedhës, të përmbledhen në një raport dhe t'i paraqiten seancës plenare pa pasur debat, përveç se kur Konferenca e Kryetarëve vendos ndryshe. Pra është transparencë e shtuar kjo.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Në fakt dy transparenca ekzistojnë te ne. Njëra është transparenca e përditshme, që do të thotë se ne jemi të monitoruar nga mediet për çdo gjë që themi, dhe kjo është transparencë e qartë, madje edhe dje ju ishit shumë transparent kur folët dhe media e përcolli tamam.

E dyta janë këto OJF-të që ka qejf Vasilika, të cilat në fund të një 6-mujori bëjnë një raport dhe na thonë Eldlira foli 3 herë, kurse Bashkimi 1 herë, Spartaku ishte aktiv, Xhina nuk qe fare aktive etj. Tani, do t'i lëmë pa punë këta, Vasilika, me këtë që po bëjmë? Megjithëse edhe këta të OJF-ve e bëjnë ndonjë punë e marrin ca lekë nga agjenci të ndryshme apo nga ambasadat. Meqenëse ne jemi transparent, kjo më duket e tepërt, se ne firmosim një listë ku deklarojmë se jemi pjesëtarë në një komision, kemi procesverbalin, të cilën ju, zoti kryetar, na kërkoni ta miratojmë në fillim të çdo mbledhjeje, pra është një gjë që njoftohet në faqen e Kuvendit, domethënë, diskutimet dhe pyetjet. Kjo është e përditshme dhe po të marrësh procesverbalet dhe të gjitha këto, ti sheh një libër voluminoz të parlamentit ose të Komisionit të Ligjeve ku janë të gjitha pyetjet dhe diskutimet.

Çfarë do të bëjmë ne? Ta marrim prapë dhe ta paraqesim në seancë plenare dhe të themi që Komisioni i Ligjeve ka zhvilluar 1000 e ca mbledhje nga të cilat kaq ka folur Ulsi Manja, kaq Bashkimi, kaq njëri e aq tjetri? Duket sikur po tallemi me vetën. Ne këtë e nxjerrim përditë se miratohet nga ne. Kështu që këto formulime për mua janë të tepërta, më mirë lërimi se nuk ka asnjë problem, se në fund të vitit do të merrni të gjitha procesverbalet dhe do të thoni: ja kjo është e gjithë veprimtaria e komisionit, se ti nuk do të shtosh gjë mbi atë që është shkruar.

Ulsi Manja – Edhe unë kam një pyetje në funksion të asaj që thotë zoti Fino. Dakord, le të jetë ky përcaktim, se e ka bërë IPA, por në rast se Konferenca e Kryetarëve do të vendosë ndryshe, meqë duhet të jetë me debat apo me diskutime? Çfarë do të diskutohet mbi veprimtarinë e Komisionit të Ligjeve në një vit kalendarik? Çfarë do të diskutohet atje kur projektligjet që ne çojmë votohen nga 140 deputetë?

Vasilika Hysi – Të nderuar kolegë, ju keni marrë para një muaji dy raporte të fotokopjuara, raporti i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe raporti vjetor i veprimtarisë së Kuvendit. Këto nuk janë procesverbale, nuk shërbejnë për të treguar sa herë ka folur Vasilika e sa herë Fino, por kanë disa tregues të transparencës së çdo parlamenti të përcaktuar nga OSBE/ODIHR-i. Ato janë një përmbledhje se cilat janë fushat në të cilat ka vepruar Kuvendi. Fusha legislative merret me përmbajtjen, me kontrollin parlamentar, me raportimet, sa nisma ka, sa komisione hetimore janë bërë etj, pra, nuk kanë shifra siç mund të bëjnë organizatat e shoqërisë civile me monitorimet e tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ta mbaroj, se nuk do t'i mbarojmë dot kurrë 100 e ca nene!?

Në këtë kuadër, ky raport bëhet prej disa vitesh, por nuk është transparent për publikun. Është ajo që ne ia ngritëm edhe KLGJ-së. Ky raport paraqitet në seancë plenare, nuk diskutohet, pra jepet një raport i shkurtët që lexohet, dhe nëse Konferenca e Kryetarëve vendos të diskutojë çështjen e pjesëmarrjes së publikut, çështjen e konsultimit publik, cilësinë e ligjeve, kjo varet nga Konferenca e Kryetarëve. Të gjitha parlamentet e kanë këtë dhe një gjë që e kemi të bërë nga stafi, të cilin do të doja ta falënderoja për të gjithë punën voluminoze që nga sekretaritetë e komisioneve e deri të stafi i Kuvendit, nuk ka pse të mos bëhet transparente për mediet dhe qytetarët.

Zoti kryetar, a mund ta hedhim në votim për procedurë?

Aurora Mara – Jam dakord me transparencën dhe nuk ka asgjë të keqe nëse Komisioni i Ligjeve raporton në Kuvend punën e bërë, pasi është më shumë transparencë dhe asgjë më tepër. Por pse të bëhet në një seancë plenare të veçantë, kur mund të bëhet një raportim në një seancë normale?!

Vasilika Hysi – Zonja Mara, faleminderit për pyetjen!

Janë 8 komisione të përhershme, pastaj janë komisionet e posaçme, komisionet hetimore, ka raportime nga Këshilli Kombëtar i Integritit Europian, ka nga Këshilli i Rregullores dhe Mandateve, apo nga Këshilli i Legjislacionit. Ai vëzhgimi atë ditë është transparencë, dhe bëhet një herë në vit.

Ulsi Manja – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Më çudit. Ne duhet të bëjmë diçka reale tonën, Klodi, se është rregullorja jonë. Po ta shohësh në pamje të parë, nuk ka gjë se e lëmë një ditë në vit, por ajo që nuk më pëlqen është fjalia që the ti. A do të bëjmë ne një rregullore për vetën tonë? Kjo është Rregullorja e Kuvendit tonë. Kjo është Rregullorja se si të funksionojmë ne. Ne nuk mund të themi: “Hajdeni, se na kanë bërë një propozim ata të IPA-s dhe ta vëmë, se propozim është!” Jo, është jona. Na duhet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë jam duke thënë. Na duhet? Nëse na duhet, hajde ta lëmë! Nëse thua: “Është kot”, atëherë pse duhet ta vëmë, kur transparencën e kemi të përhershme? Ky është thelbi i diskutimit. Dakord, një herë në vit do të thuhet që 10 komisione kanë raportuar në një seancë plenare... Dhe çfarë është kjo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Zoti kryetar, është tjetër gjë ta kesh si parim në vetvete dhe tjetër gjë ta kesh në Rregullore.

Unë mendoj se ka ardhur koha të jetë në Rregullore. Kjo u shërben edhe komisioneve të tjera për të parë veprimtarinë e komisionit. Komisioni i Ligjeve mund të njihet edhe me veprimtarinë e komisioneve të tjera dhe anasjelltas, përveç opinionit publik. Ku është e keqja? Se po të kishte një problem, do të isha dakord ta diskutonim.

Baçi, këtu nuk është çështja se kush e propozon, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një herë në vit do ta njohësh, të paktën të detyrueshme.

Jo, ndiqe ti përditë, por e ke në raport. Raporti është shumë më i detajuar se..

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Po, zonja Hysi, si relatore dhe pastaj...

Vasilika Hysi – Të nderuar kolegë,

Të gjitha institucione europiane hartojnë raport vjetor. Raportet vjetore diskutohen dhe miratohen në seancën plenare. Ne nuk po i kërkojmë seancës plenare ta diskutojë dhe ta miratojë, por të paktën të prezantohet një raport vjetor.

Kryetar, unë kam një propozim, për procedurë. Këtë Rregullore ka dy vjet që e kanë kolegët në *e-mail* dhe deri sot shumë pak prej tyre kanë shprehur mendime dhe sugjerime. Unë do të doja të përdornim mekanizmin e votës, pro, kundër dhe abstenim.

(Deputeti Bashkim Fino ndërhyrje pa mikrofon)

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne kemi shumë seanca ku po diskutojmë pak e nga pak nenet e Rregullores, thjesht për t'i dhënë kohë këtij debati. Edhe sot, nuk do t'i mbyllim nenet e Rregullores, me sa mund të ecim deri në orën 12:00-12:30... Nuk kemi qëllim të votojmë me mekanizmin e votës pro, kundër, abstenim, sepse kjo është Rregullorja jonë. E rëndësishme është, nëse do të sforcohemi pak dhe të punojmë siç duhet, të mund ta votojmë në seancën e datës 18 korrik, që në sesionin e shtatorit ta kemi Rregulloren e re në fuqi dhe të ecim para.

Neni 13. Duke qenë se në kuadër të transparencës është një rekomandim i IPA-s dhe është një punë që ne e bëjmë vazhdimisht çdo 6-mujor dhe çdo fund viti, për efekt të transparencës së shtuar, le të jetë edhe ky raportim me formulimin që është propozuar.

Kolegët kanë gjykuar që i shërben transparencës dhe le të jetë...

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 13.

Kalojmë te neni 14.

Edhe neni 14, sipas draftit që kam përpara, është rekomandim i IPA-s dhe është në përputhje me rezolutën e Kuvendit për agjendën 2030 të Kombeve të Bashkuara.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Neni 14, të nderuar kolegë, synon të bëjë disa ndryshime të vogla në nenin 19 ekzistues, ku flitet për komisionet e përhershme dhe nënkomisionet e Kuvendit. Konkretisht, fusha e Komisionit për Integrimin Europian zgjerohet me aspektin e monitorimit të negociatave të anëtarësimit me Bashkimin e Europian. Aktualisht, ne e kemi këtë detyrim. Ka një ligj të posaçëm. Nuk ka qenë i reflektuar, sepse Rregullorja është e vitit 2004. Pra, në pikën 1 shtohet vetëm pjesa që ju e keni më të nënvizuar: “Komisioni i Integritimit Europian bën monitorimin e negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Europian”.

Gjithashtu, shtohet një pikë 1/1, me sugjerimin e kolegut Hyseni: “Në fushën e përgjegjësisë të të gjitha komisioneve parlamentare, bëjnë pjesë edhe çështjet e agjendës orientuese të zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara dhe zbatimi i angazhimeve që rrjedhin prej saj”.

Me të drejtë, zonja Bashka pyeti për mbarimin e agjendës. Agjenda është deri në vitin 2030. Kjo agjendë ka qenë deri në vitin 2010, u bë 2015, po vazhdon deri në vitin 2030 dhe do të jetë gjithë kohës, sepse problemet që ka bota për paqen, sigurinë, reduktimin e... Kemi hequr vitin. Kjo është.

Gjithashtu, në pikën 2 të nenit 19, ka një ndryshim: “Me kërkesë të kryetarit të komisionit të përhershëm, me propozim të Konferencës së Kryetarëve, mund të ngrihen nënkomisione për çështje ose detyra të caktuara, që lidhen me veprimtarinë e komisionit. Nënkomisionet mund të kenë jo më pak se 5, por jo më shumë se 9 anëtarë. Anëtarësia në nënkomision jo detyrimisht është e lidhur me anëtarësinë e komisionit të përhershëm brenda të cilit ngrihet”.

Kemi pasur një vakuum ligjor dhe nuk dinim se nga kush duhet të ishin përberë nënkomisionet.

Nga ana tjetër, kemi përcaktuar numrin minimal dhe maksimal, si dhe përbërjen.

Nënkomisionet janë me tematika të caktuara. Në Komisionin e Ligjeve, për shembull, ne jemi juristë, por mund të kemi nevojë për një anëtar të parlamentit, që ka ekspertizë në fushën e financave, çështjeve sociale, të cilat duhen adresuar. Kjo është. Ky ka qenë propozim i stafit të Kuvendit.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin...?

Po, zoti Braho.

Spartak Braho – ...Në parim, do të theksoja që duhet të kemi parasysh gjuhën e formulimit, morfologjinë, sintaksën... Fraza të mos jetë burokratike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t'i sugjeroj zotit Hyseni, që ka bërë një propozim këtu, ta shikojë këtë: “Në fushën e përgjegjësisë së të gjitha komisioneve parlamentare bëjnë pjesë edhe çështjet e agjendës orientuese të zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.” Pra, duhet të shikohet nga pikëpamja leksikore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 14, me sugjerimet që bëhen? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 14.

Kalojmë te neni 15.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“Dhe propozim të Konferencës së Kryetarëve”, të dyja. Konferenca e Kryetarëve vendos për gjithçka.

Neni 15...

Vasilika Hysi – Neni 15 sjell ndryshime në nenin 20 të Rregullores, ku flitet për anëtarësinë në komisionet e përhershme. Ky është rekomandim i projektit IPA, komponenti i dytë dhe shtohet një pikë e tretë: “Deputetët anëtarë të Komisionit për Integrimin Europian janë anëtarë edhe në komisionet e tjera të përhershme”. Pra, kërkohet që çdo anëtar i Komisionit të Integritimit detyrimisht të jetë anëtar në një nga komisionet, sepse përcjell frymën e integritimit.

Ulsi Manja – Dakord.

Edhe ky është një sugjerim me vend, meqenëse jemi në procese integruese. Anëtarët e Komisionit të Integritimit duhet të jenë të shpërndarë në komisionet e përhershme.

Kush është dakord me nenin 15? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 15.

Kalojmë te neni 16, që ndryshon nenin 21.

Vasilika Hysi – Neni 21, të nderuar kolegë, ka të bëjë me përbërjen e komisioneve të përhershme dhe nënkomisioneve të Kuvendit. Kemi një pikë të tretë, ku thuhet se si caktohen anëtarët zëvendësues. Anëtarët zëvendësues ne i kemi rregulluar me një nen të veçantë. Për rrjedhojë, pika 3 shfuqizohet dhe del si nen më vete, që është neni vijues që do të miratojmë.

Ulsi Manja – Pra, e keni shtuar si nen më vete pikën 3.

Kush është dakord me nenin 16, që pika 3 e nenit 21 të kalojë si nen më vete? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 17.

Vasilika Hysi – Neni 17. Rregullohen me një nen të veçantë anëtarët zëvendësues. Pra, shtohet neni 21/1 me përmbajtjen që e keni përpara. Në qoftë se dëshironi, mund t’jua lexoj.

Ulsi Manja – Nuk ka nevojë, sepse është një procedurë pune që bëhet përditë në Kuvendin e Shqipërisë. Thjesht ka gjetur rregullim ligjor të posaçëm në Rregullore.

Kush është dakord me nenin 17? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 18, që rregullon nenin 24.

Vasilika Hysi – Neni 18, që rregullon nenin 24, ka të bëjë me komisionet e posaçme. Në praktikë, nga stafi i Kuvendit është konstatuar që ka pasur mungesa dhe shtohet një pikë 3/1 me përmbajtjen si më poshtë (është fjala për komisionet e posaçme, si ai reformës në drejtësi apo i reformës zgjedhore, të cilave u përfundon afati kohor i veprimtarisë së komisionit dhe kërkohet shtyrja e afatit): “Kur përfundon afati kohor i veprimtarisë së komisionit të posaçëm dhe puna nuk është mbyllur ende, shtyrja e afatit bëhet nga Kuvendi me kërkesë të

arsyetuar dhe me vendim të komisionit. Kërkesa i drejtohet Konferencës së Kryetarëve jo më vonë se një javë para përfundimi të aftit, e cila, pasi e shqyrton, ia përcjell seancës plenare më të parë për votim.” Pra, në këtë mënyrë ne rregullojmë edhe rastet e nevojës së shtyrjes së komisioneve.

Gjithashtu, zoti kryetar, shtohet edhe një pikë 5: “Kur veprimtaria e komisionit të posaçëm ka për objekt përgatitjen e nismave ligjvënëse, kjo e fundit futet në rendin e ditës për shqyrtim në seancën plenare, jo më parë se 1 javë nga dita e depozitimit.” Pra, kërkohet t’u jepet kohë e mjaftueshme anëtarëve deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, që të njihen me produktin që prodhon një komision i posaçëm, si Komisioni i Reformës në Drejtësi apo Komisioni i Reformës Zgjedhore, aktualisht.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Keni rregulluar një situatë që e kemi pasur shqetësim në punën e komisioneve të posaçme, pra kalimin e afateve të komisioneve të posaçme, kur as kryetari dhe as nënkryetari nuk bënin kërkesë për shtyrjen e afatit të komisionit të posaçëm dhe detyroheshim ta ngrinin komisionin nga e para me të njëjtin objekt.

Kush është dakord me nenin 18? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 19. Shtohet një nen i ri, neni 25/1.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, ky nen shtohet me propozim të GRECO-s, pra Grupit të Shteteve Antikorrupsion të Këshillit të Europës, i cili kërkon të parashikohet një strukturë me dy shkallë, që jep masa disiplinore në rastet e shkeljeve që bëjnë deputetët, si dhe një shkallë të dytë që do të shqyrtojë ankimin.

Sugjeroj që nenin 19 të mos e diskutojmë në këtë...

Ulsi Manja – Të lihet i hapur.

Vasilika Hysi – Të lihet i hapur për ta diskutuar së bashku me kapitullin që flet për shkeljet disiplinore.

Ulsi Manja – Dakord, e lëmë të hapur.

Kalojmë te neni 20, që ndryshon nenin 26.

Vasilika Hysi - Neni 20, që ndryshon nenin 26, është program i punës së Kuvendit. Ka lindur si nevojë e problemeve që ka pasur në praktikë dhe janë plotësime të sugjeruara nga stafi i Kuvendit.

Gjëja e parë dhe më e rëndësishme është që deri më sot Konferenca e Kryetarëve miraton programin e punës për një periudhë nga 4-12 javë. Ndryshimi i vetëm këtu është që kjo periudhë të bëhet nga 3-9 javë.

Pse është e domosdoshme të bëhet kjo? Sepse shpesh ne miratojmë një kalendar të caktuar dhe gjatë rrugës përfshihen projektligje... Pra, ka një fleksibilitet më të madh. Fleksibiliteti është i nevojshëm, edhe në kuadër të përafrimit të legjislacionit, ku mund të lindë nevoja për një përfshirje më të madhe të Kuvendit.

Gjithashtu, është shtuar togfjalëshi, që, përveç marrjes së mendimit të komisioneve, përfshihen edhe shërbimet e Kuvendit. Janë ata, në fund të fundit, që e dinë nëse një projektligj është gati për t'u përfshirë ose jo në programin e punës së Kuvendit.

Në pikën 6, zoti kryetar, shtohet edhe një fjalë, që lidhet me transparencën për mediet, që ne aktualisht e bëjmë, por nuk e kishim rregulluar me ligj, që programi publikohet dhe u shpërndahet deputetëve, si dhe u vihet në dispozicion përfaqësuesve të medias pas njoftimit apo miratimit në seancë plenare. Media dhe çdo gazetar kanë të drejtën e tyre, të mos u telefonojnë individualisht deputetët, sapo programi dhe kalendari miratohen t'u vihet në dispozicion.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Më falni, zoti kryetar, kisha edhe diçka tjetër për të shtuar, që ne këto gjëra i kemi bërë për një praktikë të mirë, ndërsa tashmë janë në Rregullore.

Të nderuar kolegë, shtohet edhe një pikë 7, e cila ndryshon pikën 7 të Rregullores ekzistuese. Në pikën 7 rregullohet se çfarë futet automatikisht në programin e punës së Kuvendit, pasi këto janë thënë në mënyrë taksative. Në programin e punës së Kuvendit futen automatikisht dekretet e Presidentit të Republikës; projektet financiare ose ndryshimet e buxhetit të shtetit; projektligjet e propozuara nga deputetët, të cilat nuk kanë qenë, kjo është risi; shqyrtimi i akteve normative me fuqinë e ligjit; ligjet e kthyera për rishqyrtim me dekret të Presidentit; propozimet për zgjedhje, emërim dhe shkarkim titullarësh të organeve që zgjidhen nga Kuvendit; mocionet e kërkuara; çështje që lidhen me gjendjen e jashtëzakonshme, si dhe projektligjet ose projektvendimet e mbartura nga programi paraardhës.

Ulsi Manja – Dakord.

Neni 20, besoj se zonja Pano e ka zgjidhur. Pika 7 e nenit 26 zgjidh edhe emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të bordeve për organet...

(Diskutime pa mikrofon)

... e zgjidh këtë situatë.

Neni 20 reflekton gjithë atë që ne e kemi bërë *de facto* në veprimtarinë e përgjithshme parlamentare dhe në punën e Kuvendit, por tashmë e mbrapa do të gjejë edhe rregullim. Mua më pëlqen kjo...

(Diskutime pa mikrofon)

Të lutem, të përfshihet edhe situata që sapo parashtrova!

Ju flisni për titullarët e institucioneve që burojnë nga Kuvendi, por ne kemi edhe anëtarë bordesh që zgjidhen nga Kuvendi, por edhe shkarkohen nga Kuvendi...

(Diskutime pa mikrofon)

Patjetër të shtohet! Ne jo më larg para dy seancash votuam emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të bordeve...

(Diskutime pa mikrofon)

Patjetër që duhet të futet.

(Diskutime pa mikrofon)

Ti mund ta vendosësh kur të duash në kalendarin e punimeve të komisionit, por në rast se ka ndonjë situatë të tillë që duhet të futet automatikisht, Rregullorja duhet ta parashikojë.

Kush është dakord me nenin 20? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 20.

Kalojmë te neni 21 që ndryshon nenin 27.

Vasilika Hysi – Në fakt, këtu kemi një ndryshim shumë të vogël, zoti kryetar, të nenit...

Ulsi Manja – Ju lutem, zonja Hysi, për ekonomi kohe mos e lexoni formulimin nëse ai është i dakordësuar, pasi kolegët e kanë materialin përpara, kështu që lexoni vetëm titullin e nenit.

Vasilika Hysi – Në nenin 21, i cili i bën një ndryshim nenit 27, që është kalendarin e punimeve të Kuvendit, pika 5 ndryshon e gjitha, sepse në të shtohet edhe vënia në dispozicion të medias i kalendarit pas njoftimit dhe miratimit në seancë plenare, si dhe shtohet një pikë e re pika 5/1 me këtë përmbajtje: “Në kalendarin 3-javor të punimeve futen projektligjet dhe projektvendimet e përfshira në program, si dhe projektligjet e mbartura nga kalendarin e mëparshëm, projektaktet që propozohen nga komisionet e përhershme për procesin legjislativ, kontrollin parlamentar ose zgjedhjen dhe shkarkimin e titullarëve në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj, ose çështje që vlerësohen me prioritet nga titullari i Kuvendit dhe Konferenca e Kryetarëve”. Pjesa e shtuar është “dhe/ose Konferenca e Kryetarëve”, por në rast se do të biem dakord për propozimin që ju bëtë zoti kryetar për nenin 20, që të futen edhe anëtarët e bordit, kjo do të jetë një lloj.

Ulsi Manja – Kisha diçka për pikën 5/1, që shtohet për kalendarin 3-javor të punimeve. Fjala “3-javor” do të duhet të reflektojë atë që bënte neni 20, sepse ne thanë 3 deri në 9 javë, kurse këtu e ngushtoni, kalendari 3-javor i punimeve...

Vasilika Hysi – Programi është 3 deri në 9 javë, ndërsa kalendari është 3 javë.

Ulsi Manja – Dakord.

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Unë mendoj se duhet të heqim dorë nga formulimet, i janë vënë në dispozicion përfaqësuesve të medias, por të thuhet “bëhet publik”.

Ulsi Manja – Dakord jam me ju.

Alket Hyseni – Po të jetë bëhet publik pas njoftimit.

Ulsi Manja – Kjo është çështje e teknikës legjislative, është mëse e drejtë ajo që tha zoti Hyseni, prandaj duhet reflektuar në nenin 21.

Kush është dakord për nenin 21 me sugjerimet e bëra nga kolegët? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 22.

Vasilika Hysi – Për nenin 22 kemi një propozim të ardhur nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, një nen i munguar, por njëkohësisht është propozim i IPA-s lidhur me afatin.

Neni 22 shton një nen të ri, nenin 27/1 lidhur me rendin e ditës së seancës plenare. Pra, IPA kërkon që rendi i ditës të miratohet me urdhër të Kryetarit të Kuvendit dhe të bëhet publik...

(Diskutime pa mikrofon)

Pra, neni 22 shton një nen të ri, nenin 27/1, që bën fjalë për rendin e ditës në seancat plenare, që ne nuk e kemi pasur deri tani në parlament. Rregulli është që rendin e ditës e miraton me urdhër Kryetari i Kuvendit dhe e bën publik të paktën 2 ditë para datës së caktuar për seancë plenare. IPA propozon që afati të jetë të paktën 1 javë para, pra që deputetët të kenë mundësi të njihen me rendin e ditës dhe të përgatiten për ligjet që do të shqyrtohen në seancë. Ky është propozim, afati është nga IPA, ndërsa i gjithë neni është propozim i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, që rendi i ditës duhet të rregullohet në Rregullore.

Ulsi Manja – Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – I gjithë formulimi i nenit 27/1 është i drejtë, sepse është tashmë një praktikë e konsoliduar e Kuvendit, ku gjithçka që është bërë praktikë e mirë pune të normohet në Rregullore. Unë mendoj që afati 1 javë përpara është i pamundur të realizohet efektivisht për sa kohë që ne kemi nëpër komisione axhendën dhe kemi rregullin që të paktën 48 orë para

duhet të paraqesim raportin në seancë plenare. Në këtë mënyrë i bie që ne të punojmë 2 javë përpara...

(Diskutime pa mikrofon)

Duhet të keni parasysh një gjë, të paktën Komisioni Ligjeve, Komisioni i Ekonomisë dhe Komisioni Veprimtarisë Prodhuese, të cilat janë komisionet me fluksin më të madh të punës, ne kemi akte për të cilat edhe pse mendojmë që do t'i kryejmë për një javë konsultimi me grupet e interesit na nxjerr të papritura dhe ne na duhet t'i shtyjmë disa gjëra. Pra, nëse ne e lajmërojmë rendin e ditës një javë më parë mendoj se nuk do të jemi gjithë kohën të saktë në dhënien e informacionit ose rendi do të jetë objekt i ndryshimeve të vazhdueshme.

Për mua është më mirë të vazhdojmë me praktikën që kemi, sepse në praktikë kjo gjë efektivisht nuk ka dhënë asnjë problem nëse mbledhja lajmërohet disa ditë më parë dhe jo një javë më parë. Nëse kjo gjë ka ndonjë problem, megjithatë mendoj se praktika e punës sonë është e qartë deri tani dhe efektive.

Ulsi Manja – Ju keni bërë një rregullim të nenit 27/1, sikur projektligjet që do të shkojnë në seancë plenare janë në avancë 1 javë përpara dhe njoftohet rendi ditës. Ju e dini shumë mirë se si është praktika e punës nëpër komisione, prandaj si mund të ecim ne në avancë 1 javë përpara, pra në javën e dytë të korrikut të shqyrtojmë projektligjet që do të jenë në javën e katërt të korrikut, kjo gjë nuk mund të bëhet, zonja Pano.

Në Rregullore thuhet që 48 orë përpara seancës plenare depozitohet raporti me projektligjin dhe për këtë arsye kanë lënë këtë afat kohor që deputetët të njihen me të. Unë kam përshtypjen që kjo do të sjellë konfuzion qoftë me kalendarin, me afatin patjetër, e komisioneve edhe me kalendarin e seancës plenare. Për mua praktika që kemi aktualisht është shumë e mirë, sepse për 1 javë nuk e realizoni dot.

Zonja Hysi, të lutem!

(Diskutime pa mikrofon)

Adriatik Alimadhi – Edhe për mua 1 javë është shumë, por duke pasur shumë ngarkesë, madje t'ju them të drejtën nuk kemi arritur t'i lexojmë të gjitha materialet, prandaj mendoj të gjejmë një të mesme...

Ulsi Manja – Zoti Alimadhi, sot veprohet në këtë mënyrë, ose më saktë po ju jap një ide timen se pse nuk e realizojmë dot. Të enjten është seancë plenare, dita e premte është parashikuar që deputetët ikin në zonat e tyre dhe mbledhja e radhës është ditën e hënë dhe të martë, sepse po t'i rrimë 48-orëshit të dorëzimit të raportit në seancë plenare, ne kemi mundësi t'i shqyrtojmë projektligjet e ditës së enjte vetëm ditën e hënë dhe të martë.

Adriatik Alimadhi – Unë po ju jap një shembull. Ne kishim raportin e Prokurorit të Përgjithshëm dhe të Avokatit të Popullit, raporte me një volum të madh prej 344 faqesh. A e kuptoni se çfarë ngarkese është? Ne i kaluam në Komisionin e Ligjeve, pasi mua m'u dha mundësia që për tri ditë t'i shihja dhe kur të shkoja në seancë të isha i përgatitur, por dy ditë më duken pak.

Aurora Mara – Zgjatja e afatit nuk është për ne, por më shumë është për parashikimin e punës që do të bëjë komisioni, pasi për ne dy ditë janë mëse të mjaftueshme për t'i lexuar aktet. Ideja është që komisioni 1 javë para të parashikojë punën që do të paraqesë në Kuvend. Këtu nuk diskutohemi ne, por puna e komisionit, apo jo?

Alket Hyseni – Unë kam thënë që si rregull të jetë 1 javë, pasi mund të kemi nevoja emergjente, sepse mund të ketë ligje që kërkohen më shpejt, ose mund të ndodhemi para situatave specifike, të cilat nuk mund t'i kapërcejmë dot. Unë mendoj të përdoret termi “si rregull”.

Ulsi Manja – Zonja Mara, rendi i ditës i seancës plenare është titulli i nenit. Pse? Sepse flitet për deputetët e tjerë që nuk janë anëtarë të këtij komisioni. Pra, t'u garantohet koha të tjerëve të njihen me raportin dhe projektligjin që miratojmë ne, sepse ne jemi në rregull, sepse ne e kalojmë ligjin në parim, nen për nen, por problemi është që ky nen flet për të garantuar të drejtën e kolegëve të tjerë deputetë për t'u njohur me projektligjin dhe raportin e Komisionit të Ligjeve ose të një komisioni tjetër...

(Diskutime pa mikrofon)

Dy ditë.

(Diskutime pa mikrofon)

Kështu është praktika e deritanishme.

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Zoti kryetar, për sa kohë që ne kemi në kalendar të punimeve dhe në bazë të këtij kalendar të gjithë deputetët janë njohur me programin e punës, me aktet që do të kalojnë, me ligjet që do të shqyrtohen të gjithë kanë mundësi të jenë pranë komisioneve përgjegjëse dhe të njihen me aktet dhe raportet e komisionit, sidomos ata që kanë interes të posaçëm. Sa u takon personave që kanë interes të përgjithshëm, mendoj se dy ditë janë të mjaftueshme dhe nuk ka nevojë për afat tjetër. Kushdo që është i interesuar mund të shkojë pranë komisionit përgjegjës të njihet me raportin, me punën e të gjitha me radhë.

Ulsi Manja – Zonja Hysi, i qëndrojmë variantit të pikës 3 që keni bërë?

Në qoftë se i qëndroni variantit siç e keni dhe jo rekomandimit të IPA-s e lemë dhe e hedhim në votim kështu siç është.

Kush është dakord me nenin 22? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 23 që ndryshon nenin 28.

Vasilika Hysi – Ka një ndryshim të vogël në nenin 28, i cili bën fjalë për procedurën e përshpejtuar të rishqyrtimit të projektligjeve. Shtesa e vetme në pikën 2 është, që me procedurë të përshpejtuar nuk shqyrtohen projektligje që synojnë përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian. Në pikën 5 është një reflektim i ndryshimit që bëme pak më parë për kalendarin, i cili do të jetë 3-javor dhe programi do të jetë 3 deri 9-javor.

Ky është një propozim i IPA-s, pasi ligjet e përafrimit kërkojnë kohë dhe vëmendje të mjaftueshme dhe nuk mund të kalojnë me procedurë të përshpejtuar.

Ulsi Manja – Jemi dakord.

Hedhim në votim nenin 23. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 24 që ndryshon nenin 29.

Vasilika Hysi – Neni 29 i Rregullores bën fjalë për programin e punës dhe kalendarin e punimeve të komisioneve të përhershme. Është bërë një saktësim, sepse ky nen siç ishte kishte një përplasje të nenit 70 të Rregullores, prandaj pika 1 ka ndryshuar me propozimin e stafit të Kuvendit dhe në të thuhet: “Çdo komision i përhershëm përcakton programin e punës dhe kalendarin e punimeve të tij dhe si rregull ato hartohen, duke mbajtur parasysh programin e punës dhe kalendarin e punimeve të Kuvendit”.

Pika 1/1 shtohet me propozim të projektit IPA, komponenti dy ku thuhet që komisionet e përhershme, gjatë muajit mund të miratojnë edhe një kalendar një ose dyjavor për çështje të kontrollit parlamentar, sepse ne e kemi bërë realisht, por nuk ka gjetur rregullim.

Ulsi Manja - Dakord.

Neni 24 reflekton punën që bëjmë përditë.

Kush është pro neni 24? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka

Miratohet.

Kalojmë te neni 25 që ndryshon nenin 38, “Shqyrtimi i çështjeve”.

Vasilika Hysi - Neni 38 është shqyrtimi i çështjeve në seancë plenare. Këtu ka një ndryshim të pikës 2, ka një rregullim lidhur me faktin se mendimi i relatorit duhet të jepet të paktën 3 ditë para, me qëllim që komisioni të ketë mundësi të njihet me opinionin e relatorit.

Ulsi Manja- Kjo duhet bërë si rregull dhe disiplinon punën e stafeve, madje edhe fjala “si rregull” kam përshtypjen se do të kthehet në normë nga stafet dhe ne do t’i marrim raportet...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi - Zoti kryetar, ne kemi thënë që të paktën 3 ditë para shqyrtimit të çështjes në komision çdo koleg duhet të ketë mendimin e relatorit, sepse do të duhet të përgatitet.

Ulsi Manja - Relatorit duhet t'i vihet në kohë raporti nga stafi. Deputetit, që caktohet relator, duhet t'i vihet në dispozicion paraprakisht në dorë nga stafi raporti.

Vasilika Hysi - Në pikën 5 kemi thënë që raporti, pra sa i përket pjesës së përafrimit dhe direktivave që paraqet Komisioni i Integritit, nuk mund të jetë objekt ndryshimi në komisionin përgjegjës, janë ata profesionistët.

Ulsi Manja- Është përputhje me legjislacionin e BE-së, nuk kemi çfarë t'i ndryshojmë. Aty ku është përputhje, nuk kemi çfarë të ndryshojmë.

Vasilika Hysi- Duhet shtuar edhe një pikë 5/1. Kolegë, nuk flasim për të gjithë raportin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk më latë të jap argumentet. Komisioni i Integritit European e ka të detyrueshëm të bëjë tabelën e përafrimit të legjislacionit me direktivat. Këtë tabelë nuk e bën asnjë komision tjetër. Ne nuk mund të marrim tabelën dhe të themi që nuk jemi dakord me këtë tabelë. Te raporti ne mund të ndryshojmë çdo pjesë tjetër, por pjesa që është përafrimi i projektligjit me legjislacionin merret ashtu siç është.

Klotilda Bushka- Duhet të sigurohemi në këtë rast që çdo projektligj duhet të kalojë te Komisioni i Integritit, por nuk ka ndodhur në të gjitha rastet kjo, zoti kryetar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tabela e përputhshmërisë u pa vetëm nga komisioni ynë dhe ne e përputhëm me anën ligjore, me unisonin ligjor të praktikës penale të BE-së.

Vasilika Hysi- Nëse deri sot ka pasur raste që për çështje të rëndësishme që ne kemi detyrim të përafrojmë pjesë të legjislacionit me direktivat e BE-së nuk janë bërë sa dhe si duhet, me këtë ndryshim do të bëhen.

Pra, sa herë ka ligje që kanë të bëjnë me përafrimin, raporti i Komisionit për Integritimin European është i detyrueshëm të shqyrtohet nga komisioni përgjegjës, i cili mund të mos bjerë dakord për disa pjesë, por jo për tabelën e përafrimit që përgatit Komisioni i Integritit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të nderuar kolegë, ky raport sa i përket pjesës së përafrimit të legjislacionit dhe direktivave merret në konsideratë pa ndryshime, pra vetëm për këtë pjesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni- Te “Raporti i Komisionit për Integrimin” duhet thënë: “Për ligje që synojnë përafrimin, raporti i komisionit...”, pra shtohet ky togfjalësh që të saktësojmë që vetëm për ato ligje që synojnë përafrimin është i detyrueshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja - Për ligje që synojnë përfarimin të ekzistojë vetëm detyrimi i komisionit përgjegjës me qëllim që pa ardhur ai raport të mos e fillojë të mos mbyllë procedurën për këto ligje që synojnë përafrimin, por jo të thuhet “është i detyrueshëm për t’u shqyrtuar”. Pse është i detyrueshëm për t’u shqyrtuar?

Vasilika Hysi - Ky është një rregull i përgjithshëm, zoti kryetar. Komisioni përgjegjës nuk mund të mbyllë diskutimin pa marrë mendimet e çdo komisioni të caktuar nga konferenca e kryetarëve si komision për dhënie mendimi, ndryshe procedura është shkelur. Rasti konkret që kërkon të zgjidhet, meqenëse ne hapim negociatat dhe të gjitha ligjet do të jenë me përafrim, pra raporti i komisionit sa i përket përafrimit të legjislacionit duhet marrë në konsideratë.

Ulsi Manja – Pra, Komisioni i Integritit për çështje ose për projektligje që kanë të bëjnë me përafrimin e legjislacionit merr përgjegjësinë të jetë komision përgjegjës, edhe pse ne jemi komision përgjegjës për atë projektligj që shqyrtojmë. Pra, ky komision thoni ju, si komision përgjegjës, nuk do të mbajë përgjegjësi për tabelën e përafrimit. Kjo është logjika. Pra, ne do ta shqyrtojmë projektligjin si komision përgjegjës që pa ardhur ai raport të mos mbyllë procedurën për ligjet që synojnë përafrimin. Por jo të thuhet që është i detyrueshëm për t’u shqyrtuar. Pse është i detyrueshëm për t’u shqyrtuar?

Vasilika Hysi -Ky është një rregull i përgjithshëm, zoti kryetar. Komisioni përgjegjës nuk mund të mbyllë diskutimin pa marrë mendimet e çdo komisioni të caktuar nga Konferenca e Kryetarëve si komision për dhënie mendimi, ndryshe procedura është shkelur. Rasti konkret që kërkon të zgjidhet është që, meqenëse ne do të hapim negociatat dhe të gjitha ligjet do të jenë me përafrim, atëherë raporti i komisionit për integrimin sa i përket legjislacionit të direktivës duhet marrë në konsideratë.

Ulsi Manja - Pra, Komisioni i Integritit për çështje ose projektligje që kanë të bëjnë me përafrimin e legjislacionit merr përgjegjësinë të jetë komision përgjegjës, edhe pse ne jemi komision përgjegjës për atë projektligj që shqyrtojmë. Pra, ky komision thoni ju, si komision përgjegjës, nuk do të mbajë përgjegjësi për tabelën e përafrimit. Pra, ne do ta shqyrtojmë projektligjin, por Për tabelën e përafrimit, sipas Rregullores, do të përgjigjen ata. Gjenerali saktësimin e formulimit dhe unë jam shumë i gatshëm për këtë pjesë.

Unë jam dakord që ata të marrin përgjegjësinë e tabelës së përafrimit, ne kemi përgjegjësinë si komision përgjegjës për ta parë projektligjin siç veprojmë edhe sot.

Vasilika Hysi - Në këtë nen shtohet edhe pika 5/1, e cila rregullon se çfarë duhet të përmbajë një raport dhe standardizon raportet që hartojnë komisionet. Pra, pas miratimit në tërësi të projektligjit relatori ose relatorët hartojnë raportin të cilin ia përcjellin komisionit përgjegjës dhe seancës plenare. Raporti përmban ndryshimet e miratuara në komision, si edhe rekomandimet për komisionin përgjegjës. Për hartimin e raportit mund të kërkohet edhe ndihma nga specialistë të Këshillit të Ministrave, të lidhur me çështjen, nga shërbimi juridik dhe nga ekspertë të tjerë. Ky problem, ky rekomandim kryetar zgjidh atë problem që ne shpeshherë në debate gjatë votimit e diskutojmë që kush do të miratohet. Pra, në raport duhet thënë: “merret në konsideratë ose jo mendimi i këtij komisioni”. Ky është një problem që shmang një sërë debatesh gjatë votimit.

Alket Hyseni- Te fjalia e dytë duhet bërë dallimi me fjalinë e parë. Fjalia e parë flet për komisionet për dhënie mendimi, sepse ia çon komisionit përgjegjës. Fjalia e dytë flet për tipin e raportit. Pra, duhet të shtohet “raporti i çdo komisioni”, sepse del sikur vetëm për komisionet për dhënie mendimi është.

Vasilika Hysi - Jam dakord me mendimin e zotit Hyseni dhe Xhina.

Klotilda Bushka- Ne donim ta bënim si ndërhyrje, sepse ky formulim është nga shërbimi juridik, por, mesa shihet, është e nevojshme që te raporti i komisionit përgjegjës është shumë e rëndësishme të evidentohen rastet kur komisioni përgjegjës merr në konsideratë vërejtjet dhe sugjerimet e komisioneve për dhënie mendimi dhe të argumentojë rastet kur nuk i merr në konsideratë dhe nuk i fut në raportin e vet vërejtjet e tjera dhe arsyet pse nuk i merr në konsideratë, sepse është shumë e rëndësishme për të evituar në seancë plenare atë që tha relatorja.

Ulsi Manja- Jam dakord që komisioni përgjegjës të arsyetojë kur i merr në konsideratë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të jenë 20 sugjerime nga komisioni për dhënie mendimi dhe Komisioni i Ligjeve mund të marrë 2-3 sugjerime, pjesa tjetër e raportit mund të jetë argumentimi pse nuk pranojnë ata.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti the se e ka bërë stafi juridik, por nuk del e qartë ajo që synojmë. Raporti i komisionit përgjegjës do të duhet të jetë shpjegues për atë që ka projektligji dhe ka pranuar komisioni përgjegjës për opinionin publik dhe seancën plenare. Nuk mund të jetë argumentim pse lejohen rekomandimet e komisionit për dhënie mendimi, për shembull, 5 komisione kanë qenë për dhënie mendimi te Kodi Penal. A e dini se çfarë do të thotë të arsyetojmë ne në raportin e komisionit përgjegjës pse nuk kemi pranuar amendimet e 5 komisioneve? Do të ishte një

raport me 40 faqe, ndërkohë që në seancë plenare vijnë të gjitha raportet e komisioneve për dhënie mendimi, të cilat i janë bashkëngjitur projektligjit dhe deputetët kanë mundësinë t'i shohin edhe raportet e komisioneve për dhëniet e mendimit, edhe raportet e komisionit përgjegjës që votohen në seancë plenare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Moza, je duke shpikur procedurë të re parlamentare.

Klotilda Bushka - Kam përshtypjen se mënyra si e keni formuluar është e saktë dhe jeni duke u ngatërruar kot, po zgjeroni pikërisht atë që keni parashikuar te neni. Në pikën 5, paragrafi 1, ju thoni shumë qartë: “Raporti përmban ndryshimet e miratuara në komision”. Patjetër që do t'i përmbajë se nuk ke se si ia bën me dije çfarë ndryshimesh u miratuan dhe rekomandimet për komisionin përgjegjës. Kështu është shkruar. Unë nuk shoh asnjë problem te ky formulimi dhe nuk e kuptoj pse po e diskutoni këtë pjesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimoza Pano -Në nenin 76 “Radha e votimit të amendamenteve”, në pikën 2 thuhet: “Përpara votimit të çdo amendamenti drejtuesi i seancës u rikujton deputetëve mendimin e komisionit përgjegjës për to”. Pra, në këtë rast komisioni përgjegjës vendos që të përfshijë në amendimet e tij edhe të gjitha amendimet e komisioneve për dhënie mendimi dhe bëhet votimi. Kjo është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, amendim. “U rikujton deputetëve mendimin për komisionin përgjegjës”, pra e ka fjalën për amendamentet që paraqet komisioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo janë të tjerë.

Ulsi Manja – Përse ka lindur nevoja për ta pasur 5/1, se nuk e kuptoj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, raporti është dokument parlamentar dhe sa herë që kemi pasur procedime e çështje në Gjykatën Kushtetuese janë marrë raportet e Kuvendit. Raportet nuk mund të jenë *copy – paste* i relacionit që shoqëron projektligjin që sjell qeveria, por duhet të pasqyrojë gjithë diskutimin që është bërë dhe amendamentet. Këtë ne aktualisht e bëjmë. Ne themi: “Neni “x” ndryshon bazuar në propozimin e Komisionit të Sigurisë Kombëtare”. Në radhë të parë, kjo është për transparencë.

E dyta, është për të ditur a ka nene që lobohen, sepse ligji ndryshon në komision dhe ne nuk e dimë kush është propozuesi dhe raporti nuk pasqyron asgjë lidhur me propozimin.

E treta, mund të mos jetë komisioni përgjegjës ai që ka propozuar amendamentin, por ka ardhur nga një komision për dhënie mendimi dhe përgjegjësinë morale e mban ai komision dhe për çdo sqarim të nevojshëm për të. Kjo është edhe për transparencë.

Aktualisht raportet e komisioneve nuk janë uniforme, disa janë një faqe, pra janë të thata dhe nuk japin mendimin e shumicës, pakicës, diskutimet e kështu me radhë.

Ulsi Manja – Dakord.

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Te fjalia e fundit të futen edhe deputetët propozues. Pra, kur thuhet: “Për hartimin e raportit relatorët mund të kërkojnë të ndihmohen nga specialistët e Këshillit të Ministrave, nga shërbimi juridik...”, pra të shtohen edhe deputetët iniciues në rastet kur janë.

Ulsi Manja – Dakord, pra kur nismëtarët e projektligjit janë deputetë.

Vasilika Hysi – Po kur nismëtarë janë 20 mijë qytetarë?

Alket Hyseni – Nuk marrin dot iniciativë 20 mijë qytetarë, prandaj merret eksperti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ka një sugjerim zoti Fino.

Bashkim Fino – Kam një pyetje. Zonja Hysi, për shembull: ne nuk jemi komision përgjegjës për një ligj të caktuar dhe unë jam relator, ku trajtoj një çështje për një projektligj. Për atë çfarë trajtojmë ne biem dakord të gjithë dhe ia dërgojmë komisionit përgjegjës. Komisioni përgjegjës nuk e merr fare në konsideratë, bën mbledhje dhe e rrëzon mendimin e komisionit tonë dhe ne nuk vihem në dijeni. Unë dua që në këtë rregullore, komisioni për dhënie mendimi, pavarësisht se nuk i është marrë në konsideratë vendimi për një projektligj të caktuar, duhet të vihet në dijeni nga komisioni përgjegjës për dy arsye. E para, duhet të marrë dijeni se nuk u miratua një çështje që ky komision ka propozuar.

E dyta, të lihet kohë që të bëhen propozime në seancë plenare dhe në seancë të votohen të dyja çështjet.

Kryetari i Kuvendit me të drejtë thotë: “Kalon neni kaq sipas komisionit përgjegjës”, sepse komisioni përgjegjës e ka kaluar, ndërkohë mendimi ynë si komision për dhënie mendimi nuk është marrë në konsideratë.

Moza, çfarë bëhet në këto raste, sepse dua të di që të bëjmë ndryshimin e nevojshëm, nëse duhet bërë? Gjithmonë flasim për ndryshimin e një neni që është profesional.

Ulsi Manja – Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Ka një shqetësim në vite, prandaj është bërë propozimi. Meqenëse rregulluam raportin e komisionit për dhënie mendimi, të krijojmë një rresht këtu poshtë ose një pikë më vete, ku të themi: “Raporti i komisionit përgjegjës përmban: 1, 2, 3 gjëra”, dhe nuk ka

ndonjë gjë të keqe të sqarohet se cilat propozime merren dhe cilat nuk merren, për t'ua bërë me dije palëve. Këtë e lidhim edhe me nenin që u përmend. Pra, Kryetari i Kuvendit të thotë: “Ky propozim është marrë apo jo parasysh dhe komisioni përgjegjës është apo jo dakord me këto propozime”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne mund ta bëjmë dhe nuk ka nevojë për arsyetim, thjesht të thuhet: u mor apo jo parasysh dhe qëndrimi pro e kundër propozimit.

Ulsi Manja – Projektligji të jetë me tabelë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Këtë duhet ta rregullojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika, këtë gjë duhet ta rregullojmë. Për shembull, le të mos e vënë në dijeni komisionin për dhënie mendimi, por të mos më thotë Kryetari i Kuvendit: “Nuk ke zbatuar rregulloren, sepse nuk ke sjellë një amendament”. Këtë nuk duhet të ma thotë, sepse unë e kam diskutuar në komision dhe kam dhënë mendimin se ky nen duhet ndryshuar, si komision jo përgjegjës. Ndërsa komisioni përgjegjës ka thënë nuk e marr në konsideratë mendimin e Komisionit të Ligjeve dhe jam dakord, por unë kam të drejtë të bëj diskutim apo ta votoj atë nen në seancë plenare. Pra, Kryetari nuk duhet të më thotë: “Ti nuk e ke zbatuar Rregulloren, sepse nuk ke bërë kërkesë më vete”. Çfarë kërkesë duhet të bëj kur unë kam diskutuar dhe kam marrë një vendim si komision dhe i kam thënë komisionit përgjegjës duhet ta ndryshosh këtë nen. Pra nëse Kryetari nuk më thotë që nuk ke zbatuar Rregulloren, atëherë unë jam në rregull, le të mos na e dërgojë komisioni përgjegjës mendimin e tij.

Unë them se komisioni që e përmbledh projektligjin, pasi ka marrë mendimet e komisioneve, duhet t'ua vërë në dispozicion të gjithëve mendimin e tij përpara se të shkojë në seancë plenare.

Ulsi Manja – Zonja Pano, teknikisht a ka mundësi që projektligji kur të shkojë në seancë plenare të ketë një tabelë me variantin e projektligjit, propozimet e bëra nga komisionet për dhënie mendimi dhe variantin final të projektligjit, pra të jetë në formë tabele?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkëngjitur raportit të jetë edhe tabela.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Të biem dakord që të ketë një paragraf më vete për raportin e komisionit përgjegjës, ku të parashikohet se çfarë përmban ky raport. Forma pastaj mund të jetë me ose pa tabelë.

Ulsi Manja – Zoti Braho ka një mendim të fundit dhe pastaj do ta hedhim në votim.

Spartak Braho – Ne duhet të kemi parasysh në këtë përmirësim që duam të bëjmë edhe faktin që fusha e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve, në nenin 19 të Rregullores, është e përcaktuar. Ne nuk mund të bëjmë specialistin për veprimtarinë e komisioneve të tjera që janë të specializuara, pra mund të bëhet një korrigjim, por ne shprehemi për kushtetutshmërinë dhe bazën ligjore. për shembull, për problemet e veterinarisë që i takojnë Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, nuk mundet që Komisioni i Ligjeve të fillojë të bëjë amendamente dhe të kërkojmë llogari përse nuk na miratohen...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të mbaroj një herë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket, deputetit nuk i thua dot, edhe këtu në komision, mos fol se kryesia nuk të jep të drejtë. Unë kam këtë mendim dhe jam specialist në një fushë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me amendament, por të mos kërkojmë ne përse nuk u miratua ligji për sportin, sepse e ke të përcaktuar në nenin 19.

Ulsi Manja – Zonja Pano, ju lutem, merrni përsipër të riformuloni paragrafin, siç e thanë zoti Fino, zoti Hyseni dhe zonja Xhina dhe përmbajtja e pikës 5/1 të dalë e qartë.

Kush është pro me nenin 25? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 26.

Zonja Hysi, a ta hedhim në votim, sepse kemi mbledhje tjetër në orën 1:00 dhe më duhet ta ndërpres mbledhjen?

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, neni 26 sjell një ndryshim në nenin 39, lidhur me risinë për mbledhjet e komisioneve, të cilat regjistrohen në mënyrë të plotë. Kjo është risia, ndërsa pjesa tjetër, si rregull për mbledhjet e komisioneve mbahet një procesverbal i përmbledhur, të cilin e ka ligji aktual. Gjithashtu, stafi i Kuvendit propozon që në pikat 4 dhe 5 fjala “i përmbledhur” të hiqet. Pra të thuhet: “Procesverbalet e mbledhjeve regjistrohen të plota dhe mbahen të plota”.

Faleminderit!

Ulsi Manja – A jeni dakord me nenin 26? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 27.

Vasilika Hysi – Neni 27 mendoj që lihet i hapur për diskutim.

Ulsi Manja – Dakord, neni 27 lihet i hapur.

Neni 28.

Vasilika Hysi – Për nenin 28 grupet parlamentare kanë mendime të ndryshme dhe ka një debat nëse bojkoti duhet të quhet veprimtari parlamentare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk jam dakord që bojkoti të quhet veprimtari parlamentare. Ky ka qenë një propozim i bërë nga kolegë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka një vendim të Gjykatës së Lartë, në këtë kuadër...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zonja Hysi, të mos futemi në debat për nenin 27, sepse kemi mbledhje tjetër. Debatin për nenin 27 ta vazhdojmë në mbledhjen e radhës.

Vasilika Hysi – Të nderuar kolegë, të gjithë deputetët e Kuvendit të Shqipërisë kanë marrë një *email* nga shërbimet e Kuvendit, prandaj, ju lutem, deri në orën 16:00 paraqisni amendamentet që keni. Rregullorja nuk mund të ndryshojë në sekond, sepse ne kemi punuar 2 vjet dhe e shikoni që përsëri ka nevojë. Rregullorja është dokument që do pjekuri, mençuri dhe kujdes. Secili nga amendamentet që do të sillni nuk do ta humb autorësinë, sepse do të lexohen me emra nga unë, prandaj na duhet edhe ne kohë sot mbasdite dhe nesër në mëngjes që të punojmë me ata që shkruajnë amendamentet.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Me nenin 27, të cilin do ta votojmë nesër, mbyllim mbledhjen e komisionit për ditën e sotme.

Ditë të mbarë.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

